

Raport për rezultatet e konsultimit publik

1. Titulli i draft aktit

Për projektligjin “Për Arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimet paraprake: 2 muaj

Konsultimet në portalin e regjistrimit elektronik: 20 ditë pune

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit publik të përdorura si vijon:

a. Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 12.12.2019-13.01.2020 dhe 18.08.2020-15.09.2020.

b. Tryeza konsultimi të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës nga të gjithë grupet e interesit të evidentuara nga punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë.

Aktivitetet e realizuara:

16 Shtator 2019, Ministria e Drejtësisë: takim me pjesëmarrës punonjës të Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësues nga të gjitha Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë në vend, përfaqësues nga zyra avokatie dhe nga organizatat jofitimprurëse me fushë veprimi që ndërlidhet me arbitrazhin.

21 Nëntor 2019, Ministria e Drejtësisë: tryezë paraprake konsultimi në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës specialistë përgjegjës dhe me ekspertë të Euralius për përgatitjen e një drafti paraprak.

3 Shkurt 2020- Tryezë Konsultimi në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës përfaqësues nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit të MD-së dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë.

28 Shkurt 2020- Tryezë konsultimi të zhvilluar në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës përfaqësues nga ICC Albania, ekspertë të fushës dhe përfaqësues nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit të MD-së.

3 Mars 2020- Tryezë konsultimi të zhvilluar në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës përfaqësues nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit të MD-së dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë.

19 Tetor 2020- Tryezë konsultimi në Ministrinë e Drejtësisë me pjesëmarrës përfaqësues nga ICC Albania, ekspertë të fushës dhe përfaqësues nga Drejtoria e Hartimit të Legjislacionit të MD-së.

Mbledhjet e kontributeve që do të përcillen në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, do të përcillen nga institucionet e interesuara nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me anë të regjistrit elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, si dhe nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezat e konsultimit të zhvilluara në Ministrinë e Drejtësisë.

4. Palët e interesit të përfshira

Projektakti është konsultuar me të gjitha grupet e interesit kryesisht me Dhomat e tregtisë dhe industrisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë;

PROJEKTLIGJ Nr. __ /2020 PËR ARBITRAZHIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	KOMENTE¹²³⁴	VENDIMI (I PRANUAR/I PRANUAR PJESËRISHT/I REFUZUAR)	VLERËSIMI
Neni 1	<u>Komente ASH⁵:</u>	Pranohet.	Vlerësim në lidhje me Komentin e

¹ Komente ICC-Shkrese nr.2020/33 Prot, datë 11.09.2020

² Komente KLGJ-Shkrese nr.3930/1, datë 02.10.2020

³ Komente MFE-Shkrese nr.16620/1, datë 09.09.2020

⁴ Komente EURALIUS-ardhur ne rruge elektronike

⁵ Komente Avokatura e Shtetit-ardhur me rrugë elektronike

<p style="text-align: center;">Objekti i ligjit</p> <p>Ky ligj rregullon arbitrazhin vendas dhe arbitrazhin ndërkombëtar kur vendi i arbitrazhit është në Republikën e Shqipërisë.</p>	<p>Sugjerorj të specifikohet në ligj cfarë do të thotë vendi i arbitrazhit. Është nje koncept i krijuar nga doktrina por në legjislacionin shqiptar nuk gjen parashikim. Vendi ose selia e arbitrazhit është vendi ligjor ku arbitrazhi zhvillohet. Duke zgjedhur selinë/vendin, palët zgjedhin legjislacionin e arbitrazhit që do të zbatohet, dhe për të cilin gjykatat kombëtare do të kenë juridiksion mbikqyrës mbi arbitrazhin. Për shembull, nëse zgjidhet vend arbitrazhi Parisi, do të thotë që nenet respektive të kodit civil francez do të zbatohen, dhe se cdo kërkesë në gjykate (p.sh. për të kundërshtuar vendimin) do të jenë gjykatat franceze</p>		<p>ASH:</p> <p>Termi “vend arbitrazhi” vlerësohet si nocion juridik procedural thelbësor në zhvillimin e procedurës së arbitrazhit. Si rrjedhojë, në përmbajtje duhet të gjej rregullim dhe koncepti, sikurse sugjeron ASH.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Qëllimi i ligjit</p> <p>Ky ligj ka si qëllim:</p> <p>a) të krijojë kuadrin ligjor për organizimin dhe zhvillimin e procedurave arbitrazhit;</p>	<p><u>Komenti i ICC:</u></p> <p>Nënparagrafi (a) ezauron plotësisht qëllimin e ligjit.</p> <p>Nënparagrafet (b) dhe (c) krijojnë përshtypjen sikur arbitrazhi është një aparat/organ i cili zhvillon një aktivitet dhe që ligji synon ta rregullojë.</p> <p>Ndërkohë që arbitrazhi është thjesht një proces/procedurë i/e dakorduar mes</p>	<p>Refuzohet.</p>	<p>Komenti nuk është reflektuar në përmbajtje të projektligjit.</p> <p>Në lidhje me sugjerimin e dhënë për qëllimin, mendojmë që sipas teknikës legislative objekti apo qëllimi i një drafti është konteksti se cfarë duhet të përmbajnë dispozitat e në terësi, të cilat janë të përcaktuara tek qëllimi i draftit.</p>

<p>b) të sigurojë ofrimin e arbitrazhit në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive;</p> <p>c) të sigurojë organizimin, miradministrimin dhe mirëfeksionimin e organeve përgjegjëse për ofrimin e arbitrazhit.</p>	<p>palëve për të zgjidhur jashtë gjykatave të krijuara me ligj mosmarrëveshjet mes tyre.</p>		<p>Konkretisht, në nenin 6, 7 dhe 8 dhe 9 të këtij projektakti parashikohen rregulla të hollësishme për mënyrën organizimit, miradministrimin dhe mirëfeksionimin e organeve përgjegjëse për ofrimin e arbitrazhit.</p> <p>Në parashikimet në vijim të projektaktit, konkretisht nenet 15, 16, 20, 24 dhe në vijim, parashikohen procedura më të hollësishme, duke u përpjekur që ti sigurojnë projektaktit më shumë qëndrueshmëri dhe garanci. Të gjitha këto dispozita parashikojnë për herë të parë një rregullim ligjor që, ka pasur si synim pozitiv rregullimin në detaje të çështjeve, që garantojnë ofrimin e arbitrazhit në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive.</p>
--	--	--	--

<p>Neni 3 Përkufizime dhe rregulla interpretimi</p>	<p><u>Koment MFE:</u> Të qartësohet në projektligj forma e organizimit të arbitrazhit ad hoc- dhe</p>	<p>Komenti i MFE pranohet pjesërisht.</p>	<p><u>Vlerësim Komenti MFE:</u></p>

<p>Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:</p> <p>a) “arbitrazh” është procedura përmes së cilës palët i delegojnë një arbitri ose një trupi gjykues arbitrash interpretimin, zbatimin ose zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, pavarësisht nëse administrohet ose jo nga një institucion arbitrazhi;</p> <p>b) “arbitër” është personi fizik, i përzgjedhur në përputhje me parashikimet e këtij ligji, për të shqyrtuar mosmarrëveshjen midis palëve të përfshira në procedurën e arbitrazhit;</p> <p>c) “marrëveshje arbitrazhi” është marrëveshja midis</p>	<p>arbitrazhit institucional, pasi duke u shprehur qartë forma e organizimit shmanget çdo paqartësi mbi statusin financiar të këtyre strukturave, që do të mënaxhojnë procesin e arbitrazhit.</p> <p><u>Komenti ICC në lidhje me teknikën legislative:</u></p> <p>Propozojmë që përkufizimi “<i>institucion arbitrazhi</i>” është një person juridik, i themeluar nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, sipas ligjit shqiptar, që ka si objekt të aktivitetit të tij organizimin e procedurave të arbitrazhit dhe rregullohet” t’i nënshtrohen vetëm institucionet e arbitrazhit vendas, sepse ato të huaja nuk mund të jenë objekt i rregullimit sipas këtij ligji apo legjislacionit shqiptar në përgjithësi.</p> <p><u>Komente EURALIUS:</u></p> <p>1. Ky përkufizim “<i>gjykatë</i>” është një organ i sistemit gjyqësor, në përputhje me parashikimet e</p>	<p>Komenti i ICC refuzohet.</p> <p><u>Komente EURALIUS:</u></p> <p>1. Refuzohet; 2. Refuzohet; 3. Në vlerësim</p>	<p>Në lidhje me sugjerimin e MFE, në përmbajtje të projektaktit, më konkretisht në përkufizimin institucion arbitrazhi dhe më tej në Kreun II, duhet të referohet legjislacioni specifik (nese do jete shoqeri/ose ojf) që rregullon formën e organizimit (me qëllim qartësimin që institucioni i arbitrazhit nuk kryen/ushtron funksione publike)</p> <p><u>Vlerësim Komenti ICC-së:</u></p> <p>Në lidhje me komentin e sugjeruar, sillet në vemendje se ky parashikim synon vetëm rregullimin e rasteve kur personat fizik/juridik të huaj kanë për qëllim të themelojnë një institucion arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë. Ky parashikim është në përputhje edhe me legjislacionin ndërkombëtar (Për ilustrim: Treaty of Lisbon- right of establishment. Nga ky rregullim, rrjedhimisht, mund të konkludohet se, këtë të drejtë personi i huaj mund ta ushtrojë e përmbushë vetëm duke themeluar një institucion sipas ligjit shqiptar.</p>
--	--	--	---

<p>palëve për të zgjidhur përmes arbitrazhit të gjitha ose disa mosmarrëveshje që kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet tyre në lidhje me një marrëdhënie të caktuar juridike, qoftë kjo kontraktore ose jo. Marrëveshja e arbitrazhit mund të jetë në formën e një një klauzole arbitrazhi brenda një kontrate ose në formën e një marrëveshjeje të posaçme;</p> <p>ç) “arbitrazh vendas” është procesi i zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje kur:</p> <p>(i) palët në marrëveshjen e arbitrazhit, në kohën e lidhjes së marrëveshjes së</p>	<p>legjislacionit në fuqi për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, vlerësohet i panevojshëm, pasi përfaqëson një term të njohur/sh të përdorshëm. <i>(Do not see the added value of such definition, since it is merely a description of a eïdely used term).</i></p> <p>2. Të qartësohet se organizimi i procedurave të arbitrazhit nga institucioni nuk është i detyrueshëm. Organizimi i procedurave të arbitrazhit i nënshtrohet institucionit të arbitrazhit vetëm kur palët kanë rënë dakord në marrëveshje të lidhur midis tyre. <i>(It should be clear that the involvement of arbitration institutions is not obligatory but based upon the decision of the parties to engage them, as such it is suggested to include the following provision: “...as per the agreement of the parties...”).</i></p> <p>3. Article 2(d)(e)(f) of the UNCITRAL model laë provide for specific rules of interpretation; Prior versions of this draft laë also included the rules on interpretation. In addition, the title of the Article retains the phrase</p>		<p><u>Vlerësim në lidhje me komentet EURALIUS:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përdorimi i termit gjykatë vlerësohet i qënësishëm në lidhje me këtë projektakt, për të saktësuar juridiksionin. 2. Sugjerimi i dhënë nuk pranohet. Për analogji, përkufizimi “arbitrazh” është procedura përmes së cilës palët i delegojnë një arbitri ose një trupi gjykues arbitrash interpretimin, <u>zbatimin ose zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, pavarësisht nëse administrohet ose jo nga një institucion arbitrazhi;</u> 3. Në vlerësim.
--	--	--	--

<p>arbitrazhit, kanë vendbanimin, vendqëndrimin ose selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; dhe</p> <p>(ii) vendi i caktuar për zhvillimin e arbitrazhit, sipas marrëveshjes së arbitrazhit, është Republika e Shqipërisë.</p> <p>d) “<i>arbitrazh ndërkombëtar</i>” është procesi i zgjidhjes së një mosmarrëveshje kur:</p> <p>(i) të dyja palët, në kohën e lidhjes së marrëveshjes së arbitrazhit, kanë vendbanimin, vendqëndrimin ose selinë në shtete të ndryshme;</p>	<p>“rules of interpretation”. Need to discuss on the need to retain or not any such provisions.</p>		
---	---	--	--

<p>(ii) vendi i arbitrazhit, kur ky është i përcaktuar në marrëveshjen e arbitrazhit, ndodhet jashtë Shqipërisë; ose</p> <p>(iii) palët kanë rënë dakord shprehimisht se objekti i marrëveshjes së arbitrazhit ka lidhje me më shumë se një vend; ose</p> <p>(iv) marrëveshja i referohet një institucioni arbitrazhi ndërkombëtar.</p> <p>dh) “gjykatë” është një organ i sistemit gjyqësor, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për organizimin e pushtetit</p>			
---	--	--	--

<p>gjqësor në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>e) <i>“gjykata e arbitrazhit”</i> është një arbitër ose një trupë kolegji arbitrash, të cilëve u është besuar nga palët vendimmarrja lidhur me zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje;</p> <p>ë) <i>“institucion arbitrazhi”</i> është një person juridik, i themeluar nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, sipas ligjit shqiptar, që ka si objekt të aktivitetit të tij organizimin e procedurave të arbitrazhit dhe rregullohet sipas dispozitave të Kreut II të këtij ligji;</p>			
<p>Neni 4 Fusha e zbatimit</p>	<p><u>Komenti ASH:</u></p>	<p>Pranohet pjesërisht komenti ASH.</p>	<p><u>Vlerësim komentit të ASH:</u></p>

<p>1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha procedurat e arbitrazhit vendas dhe ndërkombëtar kur vendi i arbitrazhit, sipas këtij ligji, është në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>2. Neni 14 i këtij ligji zbatohet edhe nëse vendi i arbitrazhit është jashtë Shqipërisë ose nuk është përcaktuar.</p> <p>3. Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Qysh nga dy institutet themelore që rregullon ky projektligj, siç janë arbitrazhi vendas dhe ai ndërkombëtar, dhe në vijim rregullat specifike mbi procedurën respektive të tyre, rezulton se nuk është marrë në konsideratë qëllimi i këtij projektligji (sikundër analizuam më lart). Konkretisht, duhet saktësuar se <u>deri në cilin moment procedural rregullat e parashikuara për arbitrazhin vendas mund të jenë të aplikueshme edhe për arbitrazhin ndërkombëtar.</u> pasi jo domosdoshmërisht çdo rregull vlen për të dyja rastet siç mund të jete shkaqet apo procedura për anulimin e një vendimi në rastin e një arbitrazhi vendas , kundrejt shkaqeve apo procedurës për anulimin e një vendimi në rastin e një arbitrazhi ndërkombëtar.</p> <p><u>Komenti EURALIUS:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> – Parashikimi duhet të referojë edhe marrëveshjet ndërkombetare si për shmb Koventën e Neë York (<i>Shouldn't the international treaties be mentioned as well, e.g. the Neë York Convention?</i>); 	<p>Refuzohet komenti Euralius.</p>	<p>Do të mbahet në konsideratë. Gjithsesi, modelet e legjislacioneve të tjera, nuk përmbajnë, rregullime specifike për arbitrazhin ndërkombëtar.</p> <p><u>Vlerësim komentit të Euralius në lidhje me teknikën legjislative:</u></p> <p>Sipas rregullave të teknikës legjislative, projektakti duhet të trajtojë njëkohësisht edhe qëllimin edhe fushën e zbatimit.</p> <p>Riformulimi i dhënë në shkresën e ICC dhe komenti EURALIUS, vlerësohet i saktë në përputhje me rregullat e teknikës legjislative dhe për sa kohë, në</p>
---	---	------------------------------------	--

	<p>– Sugjerohet që në përputhje me rregullat e teknikës legislative, të rregullohet në një nen të vetëm, duke përfshirë edhe nenin 1 (<i>Éould suggest to combine it ëith Article 1 in line ëith the rules of legislative technique (see above)</i>)</p> <p>Komenti ICC: ICC sugjeron saktësimin dhe rifromulimin e pikës 3 të nenit 4, si në vijim:</p> <p>Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit zbatohen dispozitat e Konventës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit të Nju Jork, 10 qershor 1958, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8688, datë 9.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit” dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Pranuar komenti ICC dhe EURALIUS në lidhje me saktësimin e pikës 3.</p>	<p>rastin e njohjes së vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, kërkesa drejtuar gjykatës shqiptare duhet të plotësojë edhe të gjitha kushtet që përmbahen në Konventët e Nju Jorkut. Edhe pse shteti i palës kërkuese mund të mos jetë palë në këtë Konventë, gjykata, nga ana e saj, në mungesë të rregullimeve të tjera normative të posaçme, duhet t'i përmbahet standardeve dhe kriterëve të vendosura nga kjo Konventë.</p> <p>Për sa më sipër, pika 3 riformulohet si vijon:</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Fusha e zbatimit</p> <p>3. Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit zbatohen dispozitat e Konventës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit të Nju Jork, 10 qershor 1958, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8688, datë 9.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të</p>
--	--	--	--

			arbitrazhit” dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.
<p>Neni 6</p> <p>Regjistrimi i institucioneve të arbitrazhit</p> <p>1. Institucioni i arbitrazhit themelohet dhe regjistrohet si person juridik, sipas legjislacionit shqiptar dhe ka si objekt të veprimtarisë organizimin e procedurave të arbitrazhit.</p> <p>2. Institucioni i arbitrazhit fillon ushtrimin e aktivitetit pas regjistrimit në Regjistrin e Institucioneve të Arbitrazhit të</p>	<p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>1. Pse duhet të organizohet si person juridik? Po nëse një ojf apo agjenci ka për qëllim të ushtrojë veprimtari si institucion arbitrazhi? (<i>Ëhat if the private association or state agency wants to run an arbitration? And I fully agree ëith the comments beloë</i>)</p> <p>2. Jeni bazuar në modele/legjislacionin e vendeve të rajonit? Bazuar në analizën tonë, legjislacioni BE nuk përmban dispozita të ngjashme, gjithashtu nuk e vlerësojmë si vlerë të shtuar apo të nevojshme përfshirjen e MD në regjistrimin e institucioneve,</p>	<p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>1. Refuzohet;</p> <p>2. Pranohet pjesërisht</p>	<p><u>Vlerësim komenti Euralius:</u></p> <p>1. Sipas përkufizimit të dhënë në nenet 24, 25 dhe 26 të Kodit Civil të Republikës së shqipërisë, termi person juridik përfshin njëkohësisht personat publikë dhe privat (si ojf, agjencitë shtetërore). Nenet e mësipërme bëjnë një kategorizim të qartë, cilët janë personat juridikë publik dhe cilët janë personat juridik privat. Gjithsesi, vlerësojmë se në përmbajtje, duhet të qartësohet forma e organizimit dhe specifikohet ligji që rregullon krijimin dhe organizimin. Agjencitë shtetërore nuk mund të</p>

<p>mbajtur pranë Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me këtë ligj.</p> <p>3. Institucioni i arbitrazhit ushtron aktivitetin në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e tij procedurale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Organizimi i Institucionit të Arbitrazhit</p> <p>1. Institucioni i arbitrazhit publikon në faqen e internetit të dhënat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) emrin dhe adresën e institucionit; b) vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe orarin zyrtar; c) tarifatat e arbitrazhit dhe numrin e llogarisë bankare të institucionit të arbitrazhit për kryerjen e pagesave nga palët; 	<p>duke qënë se procedura e arbitrazhit është shumë teknike dhe në shumë vende, institucionet e arbitrazhit janë më shumë të lidhura me dhomat e tregtisë, se sa personat juridik. <i>(Are there any models in the region and further afield that you can refer to?! Based on our analysis there are no comparable provisions anyëhere in EU MS, also do not see the added value of the registration by MoJ being that majority of arbitration is highly technical and in most countries Arbitration Institutions are closely connected to Chambers of Commerce rather than legal institutions).</i></p> <p>3. Are there any models in the region and further afield that you can refer to?! These provisions seem too detailed; need to discuss whether they are necessary or whether they may be delegated to a sublegal level</p> <p><u>Komenti ICC:</u></p> <p>Propozojmë që i gjithë Kreu II të hiqet. Qëllimi i ligjit për arbitrazhin është të rregullojë procedurën e arbitrazhit. Arbitrazhi është një formë e zgjidhjes së</p>	<p>Komenti ICC refuzohet pjesërisht.</p>	<p>organizojnë procedura arbitrazhi pasi sipas ligjit të posacëm kryejnë funksione publike.</p> <ul style="list-style-type: none"> 2. Për analogji komenti i dhënë më poshtë në lidhje me komentin e ICC-së. 3. Bazuar kryesisht në modelin e ligjit për arbitrazhin të Lituanisë, Serbisë, Kroacisë dhe Italisë. <p><u>Vlerësim në lidhje me Komentin e ICC:</u></p> <p>Në projektligj arbitrazhi institucional është konceptuar si institucion që formohet me qëllim zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve të arbitrazhit</p>
---	---	--	---

<p>ç) rregullat procedurale të institucionit;</p> <p>d) listën e arbitrave të institucionit të arbitrazhit;</p> <p>dh) informacionet e kontaktit (adresa, numri i telefonit, adresa e-mail); dhe</p> <p>e) të dhëna të tjera të nevojshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8</p> <p style="text-align: center;">Rregullat procedurale të institucionit të arbitrazhit</p> <p>1. Rregullat procedurale të institucionit të arbitrazhit duhet të përcaktojnë:</p> <p>a) themeluesin e institucionit të arbitrazhit;</p> <p>b) emrin e institucionit të arbitrazhit;</p> <p>c) procedurat për emërimin dhe përfundimin e mandatit të arbitrave;</p>	<p>mosmarrëveshjeve që rregullohet tërësisht sipas marrëveshjes/vullnetit të palëve si alternativë zëvendësuese e zgjidhjes gjyqësore.</p> <p>Kontrolli apo mbikqyrja e institucioneve të arbitrazhit nga pushteti ekzekutiv do të cenonte lirinë e palëve në zgjedhjen e tyre. Rregullimi i institucioneve të arbitrazhit vendas në këtë mënyrë të ngurtë, e sidomos përfshirja e Ministrisë së Drejtësisë apo e çdo hallke tjetër e pushtetit ekzekutiv, do të vendoste në një pozitë të pafavorshme institucionet e arbitrazhit vendas kundrejt atyre të huaja të cilat nuk i nënshtrohen këtij rregullimi.</p> <p>Format e organizimit të institucioneve të arbitrazhit mund të jenë nga më të ndryshmet. Ato mund të jenë persona juridikë që kanë për objekt ekskluziv administrimin e procedurës së arbitrazhit apo mund të jenë dhoma tregtie apo organizata biznesi të cilat mund ta ofrojnë edhe këtë shërbim</p> <p>Ligji për Arbitrazhin i Republikës së Kosovës është një shembull i mirë që duhet marrë në konsideratë në këtë drejtim. Ai nuk trajton fare mënyrën e rregullimit të institucioneve të arbitrazhit, por përqendrohet vetëm në organizimin e procesit dhe vendimet e arbitrazhit.</p>		<p>në rastet kur palët kontraktjnë kompetencën e tij dhe kanë rënë dakord që do të zbatojnë rregullat e këtij institucioni. Në mënyrë që mosmarrëveshja e arbitrazhit ti nënshtrohet kompetencës së arbitrazhit institucional, palët në marrëveshjen e tyre duhet qartë dhe plotësisht të përcaktojnë emrin e institucionit përkatës, i cili me qëllim shmangien e konfuzionit në praktikë, nuk duhet jetë i njëjtë ose i ngjashëm, me emra në trajtën e shquar apo shkurtimet përkatëse të shteteve, qyteteve, krahinave gjeografike, organizatave ndërkombëtare, fetare ose institucioneve të pushtetit qendror apo vendor, pa shtesa dalluese ose me emra, që janë në kundërshtim me rendin e moralin publik.</p> <p>Institucioni i arbitrazhit merret me organizimin e arbitrazhit dhe drejton arbitrazhin në përputhje me rregulloren e tij. Institucioni i arbitrazhit, ndryshe nga tribunalet ad hoc, nuk pushon së funksionuari edhe pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes, përkundrazi duke pasur personalitet juridik, vazhdon të ushtrojë veprimtari</p>
---	--	--	--

<p>ç) procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh, përfshirë afatet procedurale, procedurat e paraqitjes së kërkesës për arbitrazh, kërkesëpadive, kundërpadive, procedurat për shqyrtimin ose shtyrjen e mosmarrëveshjeve objekt shqyrtimi, si dhe pezullimin dhe rifillimin e procedurave të arbitrazhit.</p> <p>2. Rregullat procedurale të institucionit të arbitrazhit mund të rregullojnë edhe çështje të tjera procedurale në përputhje me këtë ligj, të tilla si:</p> <p>a) procedurat me të cilat vërtetohen nënshkrimet e arbitrave në vendime;</p> <p>b) shpenzimet e procedurave të arbitrazhit, tarifatat e arbitrit dhe procedurat e pagesës si dhe procedurat e rimbursimit të</p>	<p>Eksperiencia e deritanishme në Kosovë tregon se ligji në këtë vend funksionon plotësisht.</p>		<p>për një periudhë të pakufizuar kohore, në varësi të rregullimeve në aktin e themelimit. Institucionet e arbitrazhit sipas nenit 8 duhet sigurojnë strukturë të përhershme organizative, kushte teknike, rregulla procedurale dhe listë të arbitrave.</p> <p>Dispozitat ligjore mbi organizimin e arbitrazhit institucional janë hartuar duke mbajtur në konsideratë dhe reflektuar rregullimet që parashikohen në shumë institucione të arbitrazhit që gëzojnë reputacion ndërkombëtar, në mesin e të cilave është edhe Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit e Dhomës Ndërkombëtare Tregtare në Paris (ICC International Court of Arbitration), Gjykata e Londrës e Arbitrazhit Ndërkombëtar, si dhe bazuar kryesisht në modelin e ligjit për arbitrazhin të Lituanisë, Serbisë, Kroacisë dhe Italisë.</p> <p>Nëpërmjet mundësisht në përmbajtje të projektligjit të organizimit të procedurave të arbitrazhit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në arbitrazh, ligjvënësi synon që të sigurohet një procedurë më efikase dhe më e shpejtë e arbitrazhit, si dhe</p>
--	--	--	---

<p>shpenzimeve të procedurave të arbitrazhit; c) dispozita të tjera që rregullojnë funksionimin e institucionit të arbitrazhit.</p> <p>3. Lista e arbitrave duhet t'i bashkëngjitet rregullave procedurale të institucionit të arbitrazhit.</p> <p>4. Rregullat e procedurale të insitucionit të arbitrazhit, së bashku me listën e arbitrave dhe dokumentacionin që vërteton se arbitrat plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji depozitohen në Ministrinë e Drejtësisë, që mban Regjistrin e Institucioneve të Arbitrazhit.</p> <p>5. Në rast ndryshimesh të rregullave procedurale të arbitrazhit, institucioni ka detyrimin të depozitojë ne</p>	<p><u>Komenti KLGJ-së:</u></p> <p>Në nenin 8, konstatohet së në projektligj parashikohet krijimi i rregullave procedurale të institucionit të arbitrazhit, rregulla të cilat sipas frymës së aktit përpilohen dhe përcaktohen nga secili</p>	<p>Refuzuar komenti KLGJ.</p>	<p>zvogëlim i shpenzimeve procedurale.</p> <p>Përparësitë kryesore të arbitrazhit institucional janë se procesin e menaxhon <u>institucioni i cili përcakton rregullat e procedurës, tarifat, mirëmban një trup arbitrash për të cilët po ashtu përcakton standardet.</u></p> <p>Gjithsesi, në përmbajtje duhen rishikuar disa dispozita, të cilat në praktikë mund të përkthehen si kontroll apo mbikqyrje e shtuar përkundrejt institucioneve të arbitrazhit nga pushteti ekzekutiv. Për ilustrim, vlerësojmë të rishikohen dispozitat që përfshijnë MD në regjistrimin e institucioneve apo numri minimal i arbitrave. Rregullat procedurale sugjerohet të përcaktohen në aktin e krijimit të institucionit dhe jo në përmbajtje të këtij projektakti.</p> <p><u>Vlerësim në lidhje me Komentin e KLGJ-së:</u></p> <p>Rregullimi i institucioneve të arbitrazhit vendas në mënyrë shumë më të hollësishme se përmbajtja</p>
--	---	--------------------------------------	---

<p>Regjistrin e Institucioneve të Arbitrazhit tekstin e rregullave të përditësuara të arbitrazhit, jo më vonë se shtatë ditë pas miratimit të ndryshimeve. Në rast ndryshimi të listës së arbitrave të institucionit të arbitrazhit, institucioni ka detyrimin të depozitojë listën e përditësuar të arbitrave, bashkë me dokumentacionin që vërteton se arbitrat plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 15 të këtij ligji.</p> <p>6. Një herë në vit, brenda datës 1 Mars të çdo viti, përfaqësuesi ligjor i institucionit të përhershëm të arbitrazhit duhet t'i dërgojë Ministrisë së Drejtësisë konfirmimin se lista e arbitrave është e përditësuar.</p> <p>7. Ministria e Drejtësisë publikon në faqen internet të saj rregullat proceduriale të të</p>	<p>institucion i arbitrazhit. Duke patur parasysh parimin e sigurisë juridike si dhe një procesi të rregulluar dhe formalizuar nga ana e gjyqimit në arbitrazh, vlerësohet së këto rregulla duhet të jenë të unifikuara, osë në mos të unifikuara, të ketë korniza specifike në lidhje me përmbajtjene tyre. Lënia në çmim të secilit institucion të arbitrazhit të përcaktimit dhe përpilimit të këtyre rregullave, do të sillte një situatë kaotike dhe mënyra të ndryshme të zhvillimit në arbitrazh nga institucionet e arbitrazhit, gjë e cila sjell dhe probleme në mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të arbitrazhit, pasi për objekte të njëjta të mosmarrëveshjeve do kishim zgjidhje të ndryshme të tyre nga këto institucione.</p>		<p>aktuale, do të vendoste në një pozitë të pafavorshme institucionet e arbitrazhit vendas kundrejt atyre të huaja të cilat nuk i nënshtrohen këtij rregullimi.</p>
--	--	--	---

<p>gjitha institucioneve të arbitrazhit të regjistruara në Regjistrin e Institucioneve të Arbitrazhit.</p> <p>Neni 9</p> <p>Shkaqet për përfundimin e veprimtarisë së institucionit të arbitrazhit</p> <p>1. Nëse një institucion arbitrazhi nuk plotëson kërkesat e parashikuara në këtë ligj ose themeluesi nuk dorëzon brenda afatit konfirmimin se lista e arbitrave është e përditësuar, Ministria e Drejtësisë vendos përjashtimin e institucionit të arbitrazhit nga Regjistri i Institucioneve të Arbitrazhit.</p>			
<p>Neni 10</p> <p>Objekti i marrëveshjes së arbitrazhit</p>	<p><u>Komenti ICC:</u></p> <p>1. Sugjerojmë një listë shteruese, me rastet kur nuk lejohet që</p>	<p>Komenti ICC-së pranuar pjesërisht.</p>	<p><u>Vlerësim në lidhje me komentet e ICC-së:</u></p>

<p>1. Objekt i një marrëveshjeje arbitrazhi mund të jetë çdo pretendim pasuror ose kërkesë që rrjedh nga një marrëdhënie pasurore, me përjashtim të rastit kur legjislacioni i posaçëm e ndalon zgjidhjen nëpërmjet arbitrazhit.</p>	<p>mosmarrëveshja të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit (psh. çështjet familjare, administrative, penale, tatim/taksa etj). Në rast se një vendim arbitrazhi i marrë në Shqipëri, paraqitet përpara një vendi të huaj për t'u njohur dhe ekzekutuar konform nenit 5/2/a të Konventës së Nju York-ut, kufizon rastet kur gjykatat e shtetit të huaj të mund të gabojnë duke mos pranuar njohjen e vendimit të arbitrazhit të dhënë në Shqipëri.</p> <p>2. Dokumenti i relacionit i projektligjit, fq.9, objekti mbulon marrëveshjet juridiko-civile dhe ekonomiko-juridike duke përjashtuar çështjet familjare, sendet e paluajtshme dhe falimentimin. Ndërsa, neni 3 (c) mbulon marrëdhënie të caktuara juridike qoftë kjo kontratore ose jo dhe nuk ka kufizime të përcaktuara. Duhet të përcaktohet qartë objekti i marrëveshjes së arbitrazhit. Rregullat UNCITRAL të huazuara i takojnë marrëdhënieve</p>		<p>1. Sa i takon komentit në lidhje me listen shteruese me rastet kur nuk lejohet që mosmarrëveshja të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit, vlerësohet i panevojshëm në përmbajtje të këtij nenin, për sa kohë del qartë nga neni 1, objekti i marrëveshjes. Hartuesi kur ka bërë këtë parashikim gjithëpërfshirës në nenin 1, ka patur parasysh pikërisht respektimin e parashikimeve ligjore, <u>duke qartësuar në rregullim, edhe raset kur legjislacioni i posaçëm e ndalon ose e lejon zgjidhjen nëpërmjet arbitrazhit.</u> Si shëmbull, sjellim ligjin gjerman i cili përmban një rregullim të ngjashëm “se objekt mund të jetë çdo pretendim ekonomik”.⁶</p> <p>2. Sugjerimi i dytë pranohet dhe do të reflektohet në relacionin shoqërues. Ndërsa, për sa i takon argumentit se në rast se</p>
--	---	--	---

⁶ **Section 1030 Arbitrability:** *Any claim involving an economic interest ("vermögensrechtlicher Anspruch") can be the subject of an arbitration agreement. An arbitration agreement concerning claims not involving an economic interest shall have legal effect to the extent that the parties are entitled to conclude a settlement on the issue in dispute.*

	<p>kontraktore me natyrë tregtare. Të shikohet duke marrë në konsideratë qëllimin dhe objektivat e këtij ligji. Nuk mund të lihet vend për abuzime apo interpretime në të ardhmen.</p> <p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>Nuk del qartë cili është objekti i një marrëveshje arbitrazhi. Duhet të merret në konsideratë neni 194 para 1 i Kodit të Punës. <i>(Does not come clearly enough éhat is the object of an arbitration agreement In</i></p>	<p><u>Komenti Euralius pranuar pjesërisht.</u></p>	<p>një vendim arbitrazhi i marrë në Shqipëri, paraqitet përpara një vendi të huaj për t'u njohur dhe ekzekutuar konform nenit 5/2/a të Konventës së Nju York-ut, kufizon rastet kur gjykatat e shtetit të huaj të mund të gabojnë duke mos pranuar njohjen e vendimit të arbitrazhit të dhënë në Shqipëri, vlerësojmë se nuk qëndron, pasi gjykata e huaj gjatë ekzekutimit të vendimi nuk lidhet me përcaktimin e objektit të marrëveshjes, por, në çështjet gjyqësore me objekt kërkimi dhënien fuqi të vendimeve të të huaja të arbitrazhit, objekti i hetimit gjyqësor është verifikimi i ekzistencën ose jo të ndonjëres prej pengesave ligjore substanciale që parashikohen nga Konventa së Nju York-ut.</p> <p><u>Vlerësim komentit të Euralius:</u> Në lidhje me sugjerimin e dhënë nga Euralius për referimin e nenit 194 të Kodit të Punës sugjerohet që të merret</p>
--	---	---	--

	<p><i>addition, please refer to Article 194 paragraph 1 of the Labour Code and the role of the Ministry responsible for labour in those cases).</i></p>		<p>si shmb ligji gjerman i cili parashikon se:</p> <p>Statutory provisions outside this laë by virtue of ëhich certain disputes may not be submitted to arbitration, or may be submitted to arbitration only under certain conditions, remain unaffected.</p>
<p>Neni 11 Marrëveshja për arbitrazh</p> <p>3. Marrëveshja e arbitrazhit mund të lidhet nga çdo person fizik ose juridik, publik ose privat. Zotësia e personave fizikë dhe juridikë, privatë dhe publikë, për të lidhur një marrëveshje arbitrazhi dhe për të qenë palë në një procedurë arbitrazhi rregullohet nga legjislacioni i zbatueshëm ndaj tyre.</p>	<p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>Parashikim i përgjithshëm. Është i paqartë legjislacioni i referuar/ Parashikimet ligjore nuk duhet të jenë deklarative. (<i>Open ended external reference. It is not clear to ëhat legislation is being referred into. Legal certainty requires more precise definition</i>),</p> <p><u>Komenti ASH:</u></p> <p>Te percaktohet qarte i zbatueshem ndaj tyre ne ckupotim. Sipas legjislacionit te vendit kur kane seline, vendqendrimin etj??</p>	<p>Komenti Euralius dhe ASH pranohet pjesërisht.</p>	<p><u>Vlerësim komentit të Euralius dhe ASH</u></p> <p>Komenti do të reflektohet në përmbajtje të projektaktit nga pikëpamja e teknikës legjislative.</p> <p>Gjithsesi në lidhje me komentin e Euralius, sjellim në vëmendje, se parashikimi përfshin dhe persona juridikë të huaj që mund të jenë palë në marrëveshje. Si rrjedhojë, nuk mund të specifikohet në mënyrë ezauruese legjislacioni i zbatueshëm ndaj personave juridik të huaj.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 12</p> <p style="text-align: center;">Forma e marrëveshjes së arbitrazhit</p> <p>1. Marrëveshja e arbitrazhit bëhet me shkrim, ndryshe është e pavlefshme. Marrëveshja e arbitrazhit mund të jetë në formën e një klauzole për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh brenda kontratës së lidhur midis palëve ose në formën e një marrëveshjeje të posaçme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh.</p> <p>2. Marrëveshja e arbitrazhit konsiderohet me shkrim edhe nëse vullneti i palëve shprehet përmes faksit, telegramit, teleksit, postës elektronike apo mjeteve të tjera të komunikimit ose regjistrimit të të dhënave, të cilat mund të dokumentohen</p>	<p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>1. For discussion, it is worth noting that the original proposal had a separate chapter on "Arbitration in Specific Disputes", consisting of two sections regulating 'Arbitration in Consumer Relations' as well as 'Arbitration in Labour Relations', which had followed the approach of the Slovenian law on arbitration and taken into account the specific provisions of the Austrian, German, Croatian and Polish arbitration provisions. Articles 31 and 32 of the original proposal provided for specific provisions on consumer relations, which take into account the particulars of consumers by providing that the arbitration agreement between a trader and a consumer is valid only if it is entered into after the dispute arises between them and not as part of general terms of sale. Also, the prediction that the court competent to decide on consumer issues is the court of general jurisdiction of the place where the consumer has his/her</p>	<p><u>Në vlerësim komenti Euralius.</u></p>	
---	---	--	--

<p>dhe sigurojnë një provë të shkruar të marrëveshjes së arbitrazhit.</p> <p>3. Marrëveshja e arbitrazhit është e vlefshme edhe në rast se kontrata midis palëve bën referim të drejtpërdrejtë në një dokument tjetër që përmban klauzolën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me arbitrazh, me kusht që forma të jetë në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni.</p> <p>4. Marrëveshja e arbitrazhit ku një palë është konsumator duhet të nënshkruhet personalisht nga secila palë dhe kjo marrëveshje duhet të jetë e veçantë dhe e pavarur nga kontrata bazë.</p> <p>5. Klauzola e marrëveshjes së arbitrazhit, kur është pjesë e një kontrate, trajtohet si një</p>	<p>domicile, habitual residence, or temporary residence comes in support of the consumer in increasing access to justice and reducing procedural costs to the customer. Articles 33, 34 and 35 of the original proposal provided for special provisions on labour relations, which take into account the specifics of the employee-employer relationship by providing that the arbitration agreement is only valid if it is entered into after the dispute arises between the parties and not as part of the general labour contract. The exceptions to these rules could be the arbitration clauses in collective labour contracts in accordance with the provisions of Article 194, paragraph 1, of the Labour Code.</p> <p><u>Komenti ASH:</u></p> <p>Nëse i referohemi nenit 12 të draftit konstatohet se, në këtë të fundit, parashikohen me se shumti rastet e pavlefshmërisë së marrëveshjes sa i përket formës së saj, ndërsa sa i përket vlefshmërisë së kesaj marrëveshjeje në</p>	<p>Refuzohet komentimi ASH.</p>	<p><u>Vlerësim në lidhje me komentimin e ASH:</u></p> <p>Veçantia e këtij neni është të parashikojë rregulla të detajuara vetëm për formën e marrëveshjes në përputhje me parashikimet e nenit 7 të ligjit model të UNCITRAL.</p>
--	---	--	--

<p>marrëveshje e posaçme dhe e pavarur nga kushtet e tjera të kontratës. Pavlefshmëria e kontratës nuk passjell <i>ipso jure</i> pavlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit dhe anasjelltas.</p>	<p>kuptimin substancial nuk janë ezauruar të gjitha rastet sikundër mund të jete mungesa e zotësisë juridike , zotësisë për të vepruar, e diskrecionit ne rastin e nje personi juridik publik. (referuar praktikës zvicerane);</p>		<p>Domosdoshmëria e formës së marrëveshjes vjen pasi klauzola e arbitrazhit e rënë dakord mes palëve bën që pushteti gjyqësor të mos ketë juridiksion për shqyrtimin e mosmarreveshje,</p> <p>Duke qenë se në rastin kur palët zgjedhin procedurën e arbitrazhit për të gjykuar mosmarrëveshjet e tyre, kemi në të njëjtën kohë heqje <u>dorë nga gjykimi i mosmarrëveshjeve nga organet gjyqësore është mëse e domosdoshme që kjo klauzolë e arbitrazhit të jetë e vlefshme</u></p> <p>Ndërsa sa i perket vlefshmërisë se kesaj marreveshjeje ne kuptimin substancial, <u>vlerësojmë se kjo do të konstatohet rast pas rasti nga gjykata e arbitrazhit në përputhje edhe me ligjin e zbatueshëm të zgjedhur në marrëveshje.</u></p>
<p>Neni 13 Interpretimi i marrëveshjes së arbitrazhit</p> <p>Në rast dyshimi, marrëveshja e arbitrazhit interpretohet se i</p>	<p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>Sugjerohet që ligji të saktësojë që është gjykata e arbitrazhit, jo “gjykata”, kompetente për intepretimin e marrëveshjes së arbitrazhit. <i>Shouldn't the</i></p>	<p>Refuzuar komenti Euralius.</p>	<p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e Euralius:</u></p> <p>Sugjerimi është i paqartë.</p>

<p>jep kompetenca gjykatës së arbitrazhit në të gjitha mosmarrëveshjet që lindin ose rrjedhin nga kontrata ose nga marrëdhënia juridike së cilës i referohet marrëveshja e arbitrazhit.</p>	<p><i>laë state that it is the arbitration court, not "the court"? Èho is competent to interpret the arbitration agreement?</i></p> <p><u>Koment ASH:</u></p> <p>Te shtohet nje nen mbi masat e perkoeshme para gjykatave vendase.</p> <p>Para se dosja të transmetohet në gjykatën e arbitrazhit, palët mund të kërkojnë nga gjykata kompetente marrjen e masave të përkohshme dhe gjykata vendos në lidhje me të.</p> <p>Kerkesa e një pale para autoriteteve gjyqësor vendas për masa të tilla ose për zbatimin e ndonjë mase të tillë të urdhëruar nga një gjykatë arbitrazhi nuk do të konsiderohet të jetë shkelje ose heqje dorë nga marrëveshja e arbitrazhit dhe nuk do të ndikojë në kompetencat përkatëse të rezervuara për gjykatën e arbitrazhit.</p>	<p>Për tu vlerësuar komenti ASH.</p>	<p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e ASH:</u></p> <p>Drafti fillestar ka pasur një nen që rregullonte masat e përkohshme para gjykatave vëndase. Për tu rivlerësuar gjatë ripunimit të projektaktit.</p>
<p>Neni 14</p> <p>Paditë përpara gjykatave</p> <p>1. Gjykata përpara së cilës është ngritur një padi lidhur me një çështje që është objekt i një</p>	<p><u>Komenti i KLGJ-së:</u></p> <p>Në lidhje me nenin 14 pika 2, mendojmë që duhet të specifikohet një procedurë paraprake me mënyrën sesi do të vihet në lëvizje Gjykata e Rrethit si për sigurimin e padisë ashtu edhe për marrjen e provave.</p>	<p>Refuzuar komenti KLGJ.</p>	<p>Në lidhje me pikën 2 të nenit 14 sa i takon komentit në këtë pikë, vlerësojmë të panevojshëm parashikimin në mënyrë të detajuar të rregullave procedurale për sigurimin e padisë, pasi në lidhur me këtë fazë të procesit, sikurse veprohet edhe me</p>

<p>marrëveshjeje arbitrazhi, deklaron mungesën e juridiksionit dhe pushon gjykimin, përveç rastit kur marrëveshja e arbitrazhit nuk ekziston ose është haptazi e pavlefshme.</p> <p>2. Gjykata e Rrethit, me kërkesën e një pale të marrëveshjes së arbitrazhit, mund të vendosë marrjen e masave për sigurimin e padisë ose marrjen e provave, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile. Kjo dispozitë është e zbatueshme edhe në procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar.</p> <p>3. Pavarësisht ngritjes së padisë, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, procedura e arbitrazhit mund të fillojë ose vazhdojë të zhvillohet dhe gjykata e arbitrazhit mund të</p>	<p>Kjo gjë duhet bërë me qëllim që të shmanget sa më shumë të jetë e mundur zgjatja e procedurave në gjykatën e rrethit. Pasi nëse do të lihet me një referim në KprC atëherë palët do të gjenden para një siuatuete kaotike. Do tu duhet të ndjekin njëkohësisht procedurat e arbitrimin dhe të gjykatës.</p> <p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>Deklarimi i mungesës së juridiksionit sipas pikës 1 behet Ex officio/ apo me kërkesë të palëve??? <i>(Or the request from the party of the proceedings is necessary?)</i></p>	<p>Pranohet komenti Euralius.</p>	<p>kërkesat e tjera në gjykatat e shkallës së parë, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile përmbajnë rregullime të shprehura. Megjithatë, duhet të mbahet parasysh se ky projektligj ka për qëllim kryesisht garantimin dhe rregullimin në mënyrë të hollësishme të procedurës së arbitrazhit dhe rregullimit në mënyrë të shprehur të disa çështjeve të tjera që lidhen me kushtet dhe procedurën e pranueshmërisë për gjykim dhe atyre për shqyrtimin e çështjeve me shkak ligjor dhe objekt marrëveshjet e arbitrazhit.</p> <p><u>Sipas komentit të Euralius, dispozita riformulohet si vijon:</u></p> <p>Gjykata përpara së cilës është ngritur një padi lidhur me një çështje që është objekt i një marrëveshjeje arbitrazhi, edhe kryesisht, deklaron mungesën e juridiksionit dhe pushon gjykimin, përveç rastit kur marrëveshja e arbitrazhit nuk ekziston ose është haptazi e pavlefshme.</p>
---	--	-----------------------------------	--

<p>marrë vendim edhe nëse çështja është ende në shqyrtim përpara gjykatës.</p> <p>4. Gjatë zhvillimit të procedurave të arbitrazhit nuk mund të ngrihen padi në gjykatë me objekt pavlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit.</p>			
<p>Neni 15</p> <p>Kushtet për të qenë arbitër</p> <p>1. Arbitër mund të jetë vetëm personi fizik që ka zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe që plotëson kushtet si vijon:</p> <p>(a) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë për një vepër të kryer me dashje;</p> <p>(b) nuk është ndaluar nga e drejta për të ushtruar</p>	<p><u>Komenti i KLGJ-së:</u></p> <p>Në Kreun IV, “Arbitrat”, në nenin 15 sugjerojmë të këtë një përcaktim të kushteve/kritereve për të qenë arbitër, ku të këtë një rregullim ligjor më të detajuar në lidhje me kushtet e përgjithshme dhe të vecanta për të qenë i tillë. Kjo dhe për faktin që lista me arbitra duhet të paraqitet pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe të regjistrohet, ashtu si dhe të përditësohet.</p> <p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>1. Parashikimi “Arbitër mund të jetë vetëm personi fizik që ka zotësi të</p>	<p>Komenti i KLGJ-së në vlerësim.</p> <p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>1. Në vlerësim; 2. Refuzohet</p>	<p><u>Vlerësim komenti KLGJ-së:</u></p> <p>Në varësi të versionit që do të dërgohet për miratim. Në lidhje me këtë koment, përmbajtja e versionit të projektaktit të shpërndarë gjatë zhvillimit të tryezës së konsultimit, përcakton saktë në nenin 15 të tij kushtet për të qenë arbitër.</p> <p><u>Vlerësim komenti Euralius:</u></p> <p>1. Në lidhje me sugjerimin e Euralius, do të mbahet në konsideratë, në varësi të</p>

<p>funksiione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë.</p> <p>2. Asnjë person nuk përjashtohet për të vepruar si arbitër, për shkak të shtetësisë së tij, racës, seksit, gjuhës apo fesë.</p>	<p>plotë juridike për të vepruar dhe që plotëson", vlerësohet i panevojshëm. Në rast së vlerësohet i nevojshëm në funksion të qartësisë, sugjerohet që në përputhje me rregullat e teknikës, të rregullohet në nenin 16 dhe 17. (<i>Ëë fail to see the necessity for this provision. In case it is needed for clarity that only natural persons may be arbitrators, for the sake of legislative economy and the rules of legislative technique ëë suggest it be combined ëith Article 16 or Article 17.</i>)</p> <p>2. Parashikim përjashtimore, si psh a mundet sias të drejtës një magjistrat të verpojë edhe si arbitër? (Ëhat about exclusions? E.g. can a judge of the court of "normal" jurisdiction be an arbitrator? And prosecutor?)</p>		<p>versionit që do të dërgohet për miratim.</p> <p>2. Sugjerimi i dhënë në pikën 2 nuk reflektohet, pasi legjilacionet e posacme që rregullojnë statusin e magjistratit përmbajnë dispozita ligjore që ndalojnë magjistratin të ushtrojë funksione të caktuara.</p>
<p>Neni 17 Emërimi i arbitrit</p>	<p>Komenti i KLGJ-së:</p> <p>Duke qënë se arbitrazhi është një formë alternative e gjykimit dhe është një risi në të drejtën tonë, mendoj se duhet të ketë disa referime konkrete për përcaktimin e</p>	<p>Refuzuar komenti KLGJ-së</p>	<p><u>Vlerësim në lidhje me komentet e KLGJ-së:</u></p> <p>Sipas vlerësimeve të bëra nuk pranohet sugjerimi i përcjellë, pasi pikërisht ky projektakt u jep mundësi dhe liri palëve</p>

<p>1. Procedurat për emërimin e arbitrave përcaktohen nga palët.</p> <p>2. Në rast se palët nuk kanë përcaktuar me marrëveshje procedurën e emërimit të arbitrave, zbatohen dispozitat e këtij neni.</p> <p>3. Në rast se palët kanë rënë dakord që një mosmarrëveshje arbitrazhi do të zgjidhet nga institucioni i arbitrazhit, arbitrat caktohen nga lista e arbitrave në përputhje me rregullat procedurale të zbatueshme të institucionit, duke marrë parasysh barazinë e palëve.</p> <p>4. Në rast se palët kanë rënë dakord që një mosmarrëveshje arbitrazhi do zgjidhet nga arbitrazhi ad hoc, secila palë cakton një arbitër. Të dy</p>	<p>procedurës që do të caktohet nga palët. Ky përcaktim duhet të bëhet me qëllim që ligji të paraqesë një panoramë të përgjithshme mbi procedurat ku duhet të bazohen palët për të emëruar një arbitër. Për të shmangur probleme të mundshme të procesit është më mirë që të caktohen kritere procedurale të përgjithshme në ligj.</p> <p><u>Komenti Euralius:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pika 3 duhet të jetë përjashtim, duhet të vendoset pas pikës 4. This should be the exception, so suggest that it be folloëing the current paragraph 4. 2. Nuk e kuptojë, Nënkupton një panel të përbërë nga një arbitër? I don't understand? Does it mean a single-person panel? 3. Në lidhje me pikën 8 e cila parashikon se "Kryetari i gjykatës kompetente kryen emërimin e arbitrit sipas këtij neni, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, me kusht që marrëveshja e arbitrazhit të mos jetë haptazi e pavlefshme ose të mos parashikojë një arbitrazh 	<p><u>Komentet e Euralius:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Refuzohet 2. Refuzohet 3. Refuzohet 	<p>që për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë lindur ose që mund të lindin në të ardhmen, të mos i drejtohen vetëm gjykatës, por të kenë mundësi për të pasur dhe metoda të tjera alternative për zgjidhjen e konflikteve.</p> <p>Arbitrazhi i jep liri palëve që të zgjedhin persona me njohuri të specializuara për të gjykuar mosmarrëveshjet e tyre. Së dyti, arbitrat zgjidhen për një mosmarrëveshje të veçantë, dhe me zgjidhjen e saj ata shpërndahen.</p> <p><u>Vlerësim në lidhje me komentet e Euralius:</u></p> <p>Nëse palët nuk bien dakord mbi arbitrin e vetëm apo arbitrin sipas paragrafit 4 të këtij neni brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga fillimi i procedurave të arbitrazhit, sipas nenit 3 të këtij ligji, secila nga palët ka të drejtë t'i drejtohet kryetarit të gjykatës së rrethit gjyqësor ku ndodhet vendi i arbitrazhit për të bërë emërimin e arbitrit ose Institucionit të arbitrazhit të caktuar me marrëveshje nga palët.</p>
---	--	--	--

<p>arbitrat me marrëveshje caktojnë, arbitrin e tretë, i cili do të jetë kryesuesi i trupit gjykues të arbitrazhit.</p> <p>5. Gjykata e arbitrazhit mund të përbëhet edhe nga një arbitër, nëse palët bien dakord.</p> <p>6. Nëse një palë emëron një arbitër dhe njofton palën tjetër për të, ajo nuk mund të revokojë/zëvendësojë këtë arbitër pa pëlqimin e palës tjetër.</p> <p>7. Nëse palët nuk bien dakord mbi arbitrin e vetëm brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga fillimi i procedurave të arbitrazhit, sipas nenit 3 të këtij ligji, secila nga palët ka të drejtë t'i drejtohet kryetarit të gjykatës së rrethit gjyqësor ku ndodhet vendi i arbitrazhit për të bërë emërimin e arbitrit.</p>	<p>jashtë Shqipërisë”, të saktësohet nëse do të emërojnë një arbitër nga lista e arbitrave apo këdo. (<i>Është it be someone from the list of arbitrators or it could be anyone?</i>).</p> <p><u>Komenti ASH:</u></p> <p>Po nëse zbulohen fakte që çenojnë pavërsinë dhe paanësinë e arbitrit, pas vendimit të kryetarit të gjykatës?</p>	<p>Pranohet komenti ASH.</p>	<p>Kryetari i gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë apo institucionit i arbitrazhit të caktuar me marrëveshje nga palët kryen emërimin e arbitrit sipas këtij neni, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës, me kusht që marrëveshja e arbitrazhit të mos jetë e pavlefshme ose të mos parashikojë një arbitrazh jashtë Shqipërisë.</p> <p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e ASH:</u></p> <p>Gjatë ripunimit të projektaktit do të rivlerësohet sugjerimi, duke mbajtur në konsideratë njëkohësisht edhe nenin 23 të projektaktit.</p>
---	--	------------------------------	--

<p>8. Kryetari i gjykatës kompetente kryen emërimin e arbitrit sipas këtij neni, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, me kusht që marrëveshja e arbitrazhit të mos jetë haptazi e pavlefshme ose të mos parashikojë një arbitrazh jashtë Shqipërisë.</p> <p>9. Në emërimin e arbitrit, kryetari i gjykatës merr në konsideratë cilësitë dhe kualifikimet profesionale, sipas përcaktimeve të palëve në marrëveshjen e arbitrazhit ose që janë të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si dhe çdo rrethanë tjetër që garanton emërimin e një arbitri të pavarur dhe të paanshëm.</p> <p>10. Kundër vendimit të kryetarit të gjykatës për</p>			
--	--	--	--

<p>emërimin e arbitrit nuk lejohet ankim.</p> <p>11. Palët, në marrvëshjen e arbitrazhit ose me një akt të mëvonshëm, mund të bien dakord që emërimi i arbitrit të vetëm ose i kryetarit të kolegjit arbitral, t'i besohet një pale të tretë. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur marrëveshja e arbitrazhit parashikon emërimin e një ose disa arbitrave nga gjykata ose nëse emërimi i arbitrit i besohet një pale të tretë dhe kjo nuk merr masa për emërimin e tij.</p>			
<p>Neni 18 Zëvendësimi i arbitrit</p> <p>1. Kur, për çfarëdo arsye, një arbitër nuk është në gjendje të përmbushë detyrat e tij, jep dorëheqjen apo nuk kryen ose vonon kryerjen e një veprimi që</p>	<p>Komenti i KLGJ-së:</p> <p>Në lidhje me këtë pikë, nuk përcaktohet qartë se çfarë ndodh në këtë rast, kur procedura përfundon automatikisht, mund të rifillojë më vonë një procedurë e tillë apo jo, dhe në çfarë mënyre.</p>	<p>Pranohet.</p>	<p>Do të mbahet në konsideratë dhe saktësohet gjatë ripunimit të aktit. Si shmb ligji Serb.</p>

<p>lidhet me ushtrimin e funksioneve të tij , pala që e ka emëruar bën zëvendësimin e tij dhe ia njofton palëve dhe arbitrave të tjerë.</p> <p>2. Kur pala që ka detyrimin nuk merr masa për zëvendësimin e arbitrit, zëvendësimi i arbitrit kryhet nga Kryetari i gjykatës së rrethit gjyqësor ku ndodhet vendi i arbitrazhit, me kërkesë së palës së interesuar, dhe zbatohen rregullat e nenit 17 të këtij ligji.</p> <p>3. Në rast se arbitri nuk zëvendësohet brenda 60 ditëve nga data në të cilën ka pushuar së ushtruar funksionet e tij, procedura e arbitrazhit përfundon automatikisht. (Komenti Buljana: kjo pikë mbivendoset me pikën 2).</p>			
---	--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 20 Përgjegjësia e arbitrit</p> <p>1. Arbitri është përgjegjës për dëmet që u shkakton palëve nëse, me dashje ose pakujdesi të rëndë, nuk ka kryer ose ka vonuar kryerjen e akteve të detyrueshme brenda afatit të përcaktuar.</p> <p>2. Padia për dëmshpërblim mund të ngrihet edhe gjatë procedurës së arbitrazhit.</p> <p>3. Në rastin e njohjes së përgjegjësisë, arbitri humbet edhe të drejtën për të kërkuar pagesën e tarifës së shërbimit dhe rimbursimin e shpenzimeve.</p>	<p><u>Komenti ICC:</u></p> <p>Sugjerojmë që ky nen të hiqet. Cili është kriteri, i cili bën ndarjen midis pakujdesisë së lehtë dhe pakujdesisë së rëndë? Ky nen të krijojë përshtypjen sikur arbitrat konsiderohen palë kontraktore kundrejt palëve që anë zgjedhur të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me anë të procedurës së arbitrazhit, por ky nuk është realiteti. Arbitrat qendrojnë mbi palët, në të kundërt vendimi i tyre nuk do të kishte fuqi dhe nuk do të ishte i zbatueshëm për palët. Palët kanë mjete të tjera që mund t'i përdorin për t'u mbrojtur nga vendimet e gjykatës së arbitrazhit.</p> <p>Një problem tjetër që mund të krijojë ky nen janë paditë abuzive, të cilat janë një realitet që nuk duhet neglizhuar në Shqipëri. Ato do të dekurajonin marrjen përsipër të detyrës së arbitrit e për</p>	<p>Gjatë tryezës së konsultimit ky argument u refuzua nga ana e MD-së me argumentin që i ofron palëve me shumë garanci përkundrejt veprimeve të paligjshme ta arbitrit. Gjithsesi vlerësojë se duhet të rishikohet duke marrë në konsideratë edhe praktikën më të mira ndërkombëtare.</p>	<p>Ligji spanjoll parashikon “se arbitrat mund të jenë përgjegjës për dëmet shkaktuar nga keqbesimi, mashtrimi”. Një dispozitë e ngjashme mund të gjendet në ligjin austriak, i cili parashikon që: “arbitri që nuk ose nuk i përmbush në kohë detyrimet e tij... do të jetë përgjegjës ndaj palëve për të gjitha dëmet e shkaktuara nga refuzimi ose vonesa e kryer me faj”. Kjo është një dispozitë e detyrueshme, palët nuk mund të derogojnë me marrëveshje. Ligji rumun dhe ai italian, githashtu përmban një dispozitë të ngjashme në lidhje me përgjegjësinë. Megjithatë, <u>doktrina është unanime se përgjegjësia duhet të kufizohet në rastet e kryera me dashje ose neglizhencë të rëndë.</u></p>
<p style="text-align: center;">Neni 21 Ndalimi i pjesëmarrjes në gjykim të arbitrit</p>	<p><u>Komenti i KLGJ-së:</u></p>	<p>Komenti i KLGJ-së refuzohet.</p>	<p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e KLGJ-së:</u></p>

<p>1. Arbitri nuk mund të marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje nëse:</p> <p>a) ka qenë përfaqësues i ndonjërës nga palët ose ekspert apo dëshmitar në një çështje ku kanë marrë pjesë të njëjtat palë;</p> <p>b) nëse ai vetë ose bashkëshorti është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme më njërën nga palët ose përfaqësuesit e tyre;</p> <p>c) është në marrëdhënie pune me ndonjërën nga palët ose përfaqësuesit e tyre, ose nëse arbitri ofron këshilla ligjore ndonjërës nga palët;</p>	<p>Në shkronjën “c” të riformulohet duke shtuar pjesën “këshilla ligjore ndonjërës nga palët para se të vendosej arbitër”</p> <p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>Parashikimet janë të ngjashme me ato të KprC për përjashtimin e gjyqtarit. Ky parashikim vlerësohet se nuk është në përputhje me qëllimet e procedurës së arbitrazhit. Sugjerojmë që të parashikohet vetëm për abitrat e emëruar nga Kryetari i Gjykatës. <i>(The provisions are similar to the provisions Article 72 of the CivPC for the expulsion of judges. As elaborated above, normally arbitration is betëeen to equal commercial entities and they need to be given the necessary leeëay, thus this provision is too much in our estimation. It could be appropriate if it ëere constricted only for the arbitrators selected by the chairperson of the court of the judicial district at the place of arbitration).</i></p>	<p>Komenti i Euralius refuzohet.</p>	<p>Sugjerimi i dhënë nuk reflektohet në përmbajtje të projektligjit⁷. Gjatë hartimi të këtij parashikimi është mbajtur në konsideratë dhe është marrë parasysh “Udhëzimi i IBA për Konfliktin e Interesit në Arbitrazhin Ndërkombëtar”. Ky udhëzim e lidh përcaktimin e konfliktit të interesit me afat të caktuar “këshilla ligjore tre vjetët e fundit”. Rastet e tjera/këshillat e dhëna përtej këtij afati/ përtej këtij parashikimi, sipas këtij udhëzimi nuk do të konisderohen konflikt interesi.</p> <p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e Euralius:</u></p> <p>Për analogji komenti i dhënë më sipër.</p>
---	--	--------------------------------------	--

⁷ IBA Guidelines on Conflicts of Interest in International Arbitration

<p>d) nëse ai vetë ose bashkëshorti ose personi juridik, në të cilin është administrator ka interes në çështje ose një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë gjykim;</p> <p>2. Arbitri ka detyrimin të mos pranojë detyrën kur ekziston ndonjë prej shkaqeve për përjashtimin e tij, sipas pikës 1 të këtij neni, ose të heqë dorë nga detyra duke deklaruar shkaqet përkatëse, brenda 5 ditëve nga dita e zbulimit të cdo lloj rrethane tjetër që mund të shkaktojë dyshime të arsyeshme lidhur me paanshmërinë e tij.</p> <p>3. Nëse arbitri heq dorë nga detyra sipas kësaj dispozite, ai zëvendësohet me një arbitër të ri, në përputhje me procedurat e parashikuara në marrëveshje, në këtë ligj apo në rregullat</p>			
---	--	--	--

<p>proceduriale të institucionit të arbitrazhit.</p>			
<p style="text-align: center;">Neni 22 Rastet për përjashtimin e arbitrit</p> <p>1. Secila nga palët mund të kundërshtojë emërimin ose të kërkojë përjashtimin e një arbitri, nëse:</p> <p>a) ekziston një nga shkaqet për ndalimin e pjesëmarrjes së arbitrit, sipas nenit 21, paragrafi 1, i këtij ligji, dhe arbitri nuk ka hequr dorë nga detyra;</p> <p>b) nuk plotëson kushtet për të qenë arbitër, sipas nenit 15 të këtij ligji;</p> <p>c) nuk zotëron cilësitë shprehimisht të dakordësuara nga palët në marrëveshjen e arbitrazhit;</p> <p>ç) ekzistojnë rrethana të tjera që shkaktojnë dyshime</p>	<p><u>Komenti ICC-së:</u></p> <p>Sugjerojmë të përcaktohet afati 5 (pesë) ditor nga momenti kur arbitri merr dijani mbi këto rrethana. Në këtë mënyrë dispozita ruan të njëjtin standard të vendosur në Nenin 21, par.2</p> <p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>Në cilën gjykatë mund të kundërshtohet emërimi i arbitrit? (<i>Ëhere? In a court? State or arbitration one?</i>)</p>	<p>Pranohet sugjerimi ICC-së.</p> <p>Refuzohet komenti Euralius.</p>	<p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e ICC-së:</u></p> <p>Reflektohet në përmbajtje të projektligjit.</p> <p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e Euralius:</u></p> <p>Refuzohet. Për analogji, neni 59 i projektaktit “rastet kur lejohet ankimi”.</p>

<p>të arsyeshme lidhur me paanësinë ose pavarësinë e arbitrit.</p> <p>2. Nga data e emërimit dhe gjatë gjithë procedurës së arbitrazhit, arbitri ka detyrimin të njoftojë palët lidhur me çdo rrethanë, që mund të krijojë dyshime të arsyeshme mbi paanësinë ose pavarësinë e tij, me përjashtim të rasteve kur provohet se palët kanë marrë dijeni paraprakisht për këto rrethana.</p> <p>3. Pala nuk mund të kërkojë përjashtimin e arbitrit të emëruar prej vetë asaj, përveçse kur shkaqet për përjashtimin e tij kanë lindur ose pala është vënë në dijeni pas emërimit të arbitrit, pavarësisht se arsyet kanë ekzistuar edhe më parë. Në çdo rast, momenti i marrjes dijeni</p>			
---	--	--	--

<p>nga pala që kërkon përjashtimin e arbitrit duhet të provohet.</p>			
<p>Neni 23 Procedura për përjashtimin e arbitrit</p> <p>1. Palët mund të përcaktojnë procedurën e përjashtimit të arbitrit në marrëveshjen e arbitrazhit ose në një marrëveshje të posaçme. Në mungesë të marrëveshjes, secila nga palët mund të kërkojë me shkrim përjashtimin e arbitrit, jo më vonë se 15 ditë nga marrja dijani për shkakun e përjashtimit ose, në rast se gjykata e arbitrazhit është konstituuar, jo më vonë se 15 ditë nga konstituimi i kësaj gjykate, kur pala ka marrë dijani për shkaqet e</p>	<p><u>Komenti ICC-së:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendi i arbitrazhit nuk mund të jetë thjesht një lokacion, por ka domethënie juridike pasi ka lidhje me ligjin e vendit. Kjo do të thotë që duhet përcaktuar vetëm një Gjykatë rrethi për arbitrazhin e zhvilluar në Shqipëri. Mendojmë që kjo të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. 2. Ky vendim i takon gjykatës së arbitrazhit por jo institucionit të arbitrazhit. 	<p><u>Komenti ICC-së:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pranohet 2. Pranohet 	<p><u>Komenti ICC reflektohet në përmbajtje të projektligjit.</u></p> <p>Rifromulohet si vijon:</p> <p style="text-align: center;">Neni 23 Procedura për përjashtimin e arbitrit</p> <p>Në rast mospranimi të kërkesës për përjashtimin e arbitrit, sipas pikës 2, të këtij neni, pala ka të drejtë të bëjë ankim pranë Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të vendit të arbitrazhit apo institucionit të arbitrazhit të caktuar me marrëveshje nga palët brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e vendimit të gjykatës së arbitrazhit lidhur me përjashtimin. Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga depozitimi i kërkesës, merr</p>

<p>përrjashtimit përpara krijimit të gjykatës së arbitrazhit.</p> <p>2. Gjykata e arbitrazhit, përfshirë arbitrin kundrejt të cilit është bërë kërkesë për përrjashtim, vendos mbi përrjashtimin e arbitrit brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës, përveç rasteve kur arbitri heq dorë nga detyra ose pala tjetër pranon përrjashtimin.</p> <p>3. Në rast së kërkesa për përrjashtimin e arbitrit pranohet nga gjykata e arbitrazhit, një arbitër i ri do të emërohet në përputhje me procedurat e parashikuara në marrëveshje ose në rregullat procedurale të institucionit të arbitrazhit.</p> <p>4. Në rast mospranimi të kërkesës për përrjashtimin e arbitrit, sipas pikës 2, të këtij</p>	<p><u>Komente ASH:</u></p> <p>1. <i>“secila nga palët mund të kërkojë me shkrim përrjashtimin e arbitrit, jo më vonë se 15 ditë nga marrja dijani për shkakun e përrjashtimit ose, në rast se gjykata e arbitrazhit është konstituuar, jo më vonë se 15 ditë nga konstituimi i kësaj gjykate, kur pala ka marrë dijani për shkaqet e përrjashtimit përpara krijimit të</i></p>	<p><u>Komente ASH-së:</u></p> <p>1. Pranohet 2. Vlerësohet</p>	<p>vendim pasi dëgjon palët, duke disponuar edhe mbi shpenzimet e procedurës. Shqyrtimi i ankimit nga gjykata nuk pezullon procedurat e arbitrazhit. Kundër vendimit të Gjykatës nuk lejohet ankim.</p> <p>Palët kanë të drejtë të caktojnë vendin se ku do të zhvillohet procedura e arbitrazhit. Në rast se palët nuk e kanë caktuar, vendi i arbitrazhit përcaktohet nga gjykata e arbitrazhit, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e çështjes, si dhe përrshtatshmërinë për palët. Vendimi për përcaktimin e vendit të arbitrazhit është i paankimueshëm.</p> <p><u>Vlerësim në lidhje komentet e ASH:</u></p> <p>1. Do mbahet në konsideratë gjatë ripunimit. Si shmb ligji gjerman: <u>“Failing such agreement, a party ëho intends to challenge an arbitrator shall, ëithin tëo ëeeks after becoming aëare of the constitution of the arbitral tribunal or after becoming</u></p>
---	---	---	--

<p>neni, pala ka të drejtë të bëjë ankim pranë Kryetarit të Gjykatës së Rrethit të vendit të arbitrazhit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e vendimit të gjykatës së arbitrazhit lidhur me përjashtimin. Kryetari i Gjykatës së Rrethit, brenda 15 ditëve nga depozitimi i kërkesës, merr vendim pasi dëgjon palët, duke disponuar edhe mbi shpenzimet e procedurës. Shqyrtimi i ankimit nga gjykata nuk pezullon procedurat e arbitrazhit. Kundër vendimit të Gjykatës nuk lejohet ankim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 29 Vendi i arbitrazhit</p>	<p><i>gjykatës së arbitrazhit”. Po nëse pala ka marrë dijani për shkaqet pas konstituimit të gjykatës së arbitrazhit, ose gjatë zhvillimit të procedurave të arbitrazhit?</i></p> <p>2. <i>“Gjykata e arbitrazhit, përfshirë arbitrin kundrejt të cilit është bërë kërkesë për përjashtim vendos mbi përjashtimin e arbitrit”. A nuk cënon paanshmërinë kjo?</i></p> <p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p><i>Në pikën 4, sugjerohet të rregullohet në mënyrë të hollësishme procedura e ankimit? Afati dhe rastet kur lejohet ankimi (Does the CivPr Code foresee the procedure for such an appeal? The deadlines and grounds for the appeal? I think this is needed)</i></p>	<p>Refuzohet komenti i Euralius.</p>	<p><u>aëare of any circumstance referred</u> to in section 1036 subs. 2, send a written statement of the reasons for the challenge to the arbitral tribunal.</p> <p>2. Për analogji, ligji gjerman parashikon:</p> <p>Unless the challenged arbitrator withdraws from his office or the other party agrees to the challenge, <u>the arbitral tribunal shall decide on the challenge.</u></p> <p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e Euralius:</u></p> <p>Vlerësojmë se parashikimi përmban rregulla të detajuara.</p>
---	--	--------------------------------------	--

<p>1. Palët kanë të drejtë të caktojnë vendin se ku do të zhvillohet procedura e arbitrazhit. Në rast se palët nuk e kanë caktuar, vendi i arbitrazhit përcaktohet nga gjykata e arbitrazhit ose institucioni i arbitrazhit, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e çështjes, si dhe përshtatshmërinë për palët. Vendimi për përcaktimin e vendit të arbitrazhit është i paankimueshëm.</p> <p>2. Gjkata e arbitrazhit, pavarësisht parashikimeve të pikës 1, të këtij neni apo nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, mund të mbledhet në çdo vend që e çmon të përshtatshëm për:</p> <p>a) konsultimin ndërmjet arbitrave;</p> <p>b) dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertëve ose palëve; ose</p>			
---	--	--	--

<p>c) këqyrjen e sendeve, të luajtshme ose të paluajtshme ose çdo dokumenti tjetër.</p>			
<p>Neni 24 Trajtimi i barabartë i palëve</p> <p>1. Palët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe secilës palë i jepet mundësia e plotë për të paraqitur mjetet, shpjegimet,</p>	<p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>Parashikimi i përgjithshëm vlerësohet i panevojshëm. Po nëse pala dështon të paraqesë faktet, prapësimet brenda afatit të caktuar? <i>(Not sure if such a general statement is needed. Èhat if a party claims that they might fail ëith the deadlines</i></p>	<p>Refuzohet komenti Euralius.</p>	<p>Neni 24 përmban parimet e procesit. Zhvillimi i procedurës dhe afatet përkatëse rregullohen në nenet në vijim.</p>

<p>faktet, dokumentet dhe provat mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre në mënyrë që secila palë të mbrojë interesin e saj në gjykim.</p>	<p><i>referring to this provision? But maybe I exaggerate)</i></p>		
<p>Neni 28</p> <p>Vendimmarrja lidhur me juridiksionin e gjykatës së arbitrazhit</p> <p>1. Gjykata e arbitrazhit vendos lidhur me juridiksionin e saj për zgjidhjen e një mosmarrvëshjeje, përfshirë mbi ekzistencën apo vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit ose formimin e rregullt të kolegjit të arbitrave. Gjykata disponon mbi çështjet në kompetencën me vendim të ndërmjetëm ose me vendim përfundimtar.</p>	<p><u>Komente ASH:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Në pikën 2, kush e përcakton momentin “menjëherë”? Duhet përcaktuar konkretisht momenti procedural. 2. Akti i parë i mbrojtjes janë pretendimet fillestare të palës, paraprake, që kanë të bëjnë me çështje pranueshmërie të çështjes? Te unifikohet terminologjia pasi jemi ne momentin e paraqitjes se pergjigjes ndaj kerkeses per arbitrazh. 	<p><u>Komente ASH-së:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Refuzohet. 2. Pranohet 	<p><u>Vlerësim në lidhje me komentet e ASH:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësojmë se nuk mund të përcaktohet afat, për sa kohë është në diskrecionin e gjykatës së arbitrazhit të përcaktojë afatet gjatë zhvillimit të procedurës. Interesi i palëve për t’ja nënshtruar gjykimin e mosmarrëveshjeve arbitrazhit, bëhet pasi ato besojnë se procedura e arbitrazhit ofron për një zgjidhje më të shpejtë të problemeve të krijuara, më efektive dhe më pak të kushtueshme. 2. Do të unifikohet terminologjia.

<p>2. Pretendimi për mungesën e juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit mund të ngrihet përpara kësaj gjykate jo më vonë se dita e dorëzimit nga pala të deklaratës së mbrojtjes. Palët kanë të drejtë të paraqesin pretendime lidhur me mungesën e juridiksionit edhe nëse kanë emëruar ose kanë marrë pjesë në emërimin e një arbitri. Pretendimet lidhur me tejkalimin e kompetencës nga gjykata e arbitrazhit duhet të ngrihen menjëherë sapo çështja pretendohet të jetë jashtë kompetencës së gjykatës së arbitrazhit. Gjykata e arbitrazhit mund ta pranojë kundërshtimin edhe kur bëhet me vonesë, me kusht që të provohet se vonesa ka qenë për shkaqe të arsyeshme.</p> <p>3. Pala që nuk paraqet pretendime lidhur me</p>			
---	--	--	--

<p>vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit që në aktin e parë të mbrojtjes, pas formimit të gjykatës së arbitrazhit, nuk mundet që, për të njëjtin shkak, të ankimojë vendimin e arbitrazhit, me përjashtim të rastit kur mosmarrëveshja nuk mund të jetë objekt arbitrazhi, sipas nenit 10 të këtij ligji.</p> <p>4. Pala që nuk prapëson gjatë procedurave të arbitrazhit se pretendimet e palëve të tjera janë në tejkalim të marrëveshjes së arbitrazhit, nuk mundet që, për të njëjtin shkak, të ankimojë vendimin e arbitrazhit.</p> <p>5. Kundër vendimeve të ndërmjetme mund të paraqitet ankim në mënyrat dhe afatet e parashikuara për vendimin</p>			
---	--	--	--

<p>përfundimtar. Paraqitja e ankimit ndaj një vendimi të ndërmjetëm nuk pezullon procedurën e arbitrazhit, përveç kur gjykata e arbitrazhit vendos ta pezullojë atë deri në vendimmarrjen e gjykatës</p>			
<p>Neni 31 Njoftimi i komunikimeve me shkrim</p> <p>1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, çdo komunikim me shkrim konsiderohet i marrë nëse i dorëzohet personalisht marrësit ose nëse dorëzohet në adresën postare ose adresën elektronike (e-mail) të treguar shprehimisht nga vetë personi që duhet të marrë njoftimin. Nëse personi ka treguar edhe adresë postare edhe e-mail, njoftimi duhet të dërgohet në të dy adresat.</p>	<p>Komenti i KLGJ-së:</p> <p>Vlerësohet të riformulohet pika 5 e tij, pasi në rast se marrësi i njoftimit nuk di ose nuk mund të nënshkruajë, nuk mund të konsiderohet si i dërguar njoftimi. Ligji procedural civil si dhe ai penal kanë njohur gjuhën e shenjave.</p>	<p>Pranohet.</p>	<p>Gjatë ripunimit në terësi të projektaktit të merret në konsideratë, pasi pengesat ligjore të parashikuara nga neni 5 i Konventës së Nju Jorkut parashikojnë se:</p> <p><i>“Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur:</i></p> <p>.....</p> <p><i>b. kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet;</i></p> <p><i>c. midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është</i></p>

<p>2. Nëse marrësi nuk ka përcaktuar shprehimisht ndonjë adresë tjetër ose nëse rrethanat e çështjes nuk tregojnë ndryshe, adresë postare do të jetë adresa e selisë së marrësit, adresa e vendbanimit të tij ose adresa e referuar në kontratë ose në marrëveshjen e arbitrazhit. Rregullat e parashikuara në këtë pikë zbatohen <i>mutatis mutandis</i> në lidhje me adresën e postës elektronike.</p> <p>3. Nëse asnjë prej tyre, pavarësisht përpjekjeve të arsyeshme, nuk gjendet, komunikimi i shkruar do të konsiderohet i marrë nëse dërgohet në vendin e fundit të njohur të biznesit të marrësit, vendbanimin e zakonshëm ose adresën postare me kusht që të dërgohet përmes postës</p>			<p><i>dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;</i></p> <p><i>ç. është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë;.....”.</i></p>
---	--	--	---

<p>rekomande ose çfarëdolloj mjeti tjetër që siguron provë për përpjekjet e realizuara për dorëzimin e saj.</p> <p>4. Komunikimi me shkrim do të konsiderohet i marrë në ditën që është dërguar sipas mënyrave të mësipërme.</p> <p>5. Një njoftim me shkrim konsiderohet i dërguar, në rast se dërgimi është bërë në përputhje me parashikimet e pikës 2 dhe 3, të këtij neni, edhe nëse marrësi refuzon ta pranojë atë, nuk di ose nuk mund të nënshkruajë, sipas shënimit përkatës në aktin e njoftimit.</p> <p>6. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për njoftimet në proceset gjyqësore të cilat rregullohen nga Kodi i Procedurës Civile.</p>			
---	--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 32 Përfaqësimi i palëve</p> <p>1. Përpara gjykatës së arbitrazhit, palët mund t'i kryejnë veprimet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar.</p> <p>2. Palët janë të lira në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, të cilët do t'i përfaqësojnë ato në procedurën e arbitrazhit. Përfaqësuesi i autorizuar nga pala nuk mund të përjashtohet nga procedura e arbitrazhit.</p>	<p>Komenti ICC-së:</p> <p>Fjalja e fundit e këtij paragrafi është e paqartë dhe kërkon më shumë trajtim.</p> <p>Komenti Euralius:</p> <p>Ëho may act as representatives?! The subjects foreseen in Article 96 CivPC or also other entities?!</p>	<p>Pranohet komenti ICC-së dhe Euralius.</p>	<p>Gjatë ripunimit në terësi të projektaktit do të rregullohet në mënyrë të detajuar, duke mbajtur parasysh që në fazën e parë, gjykata e arbitrazhit verifikon përmbushjen e kushteve formalo-procedurale, pra të rregullshmërisë formale të paraqitjes dhe përfaqësimit.</p> <p>Pika 2 para 2 duhet rishikuar në terësi duke marrë në konsideratë edhe udhëzimet⁸</p> <p><u>Changes in Party representation in the course of the arbitration may, because of conflicts of interest between a newly-appointed Party Representative and one or more of the Arbitrators, threaten the integrity of the proceedings.</u></p> <p>In such case, the Arbitral Tribunal may, if compelling circumstances so justify, and where it has found that it has the requisite authority, <u>consider excluding the neë Representative from participating</u> in all or part of the arbitral proceedings. In assessing whether any such conflict of interest</p>
---	--	---	---

⁸ IBA Guidelines on Party Representation in International Arbitration.

			exists, the Arbitral Tribunal may rely on the IBA Guidelines on Conflicts of Interest in International Arbitration
<p>Neni 33</p> <p>Heqja dorë nga e drejta për kundërshtim</p> <p>1. Nëse njëra nga palët është në dijeni të shkeljes së një dispozite të këtij ligji apo të mospërmbushjes nga pala tjetër të një detyrimi që rrjedh nga marrëveshja e arbitrazhit dhe, pavarësisht kësaj, vijon procedurën e arbitrazhit, duke mos kundërshtuar menjëherë dhe, në çdo rast, jo me vonë se 5 ditë nga marrja djeni, shkeljen përkatëse, konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për kundërshtim.</p>	<p><u>Komenti ASH:</u></p> <p><i>“Jo me vonë se 5 ditë nga marrja djeni, shkeljen përkatëse, konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për kundërshtim”. Duhet konsideruar afatet.</i></p>	<p>Refuzohet komenti dhe i paqartë qellimi i sugjerimit.</p>	<p>Interesi i palëve për t’ja nënshtruar gjykimin e mosmarrëveshjeve arbitrazhit, bëhet pikërisht pasi ato besojnë se procedura e arbitrazhit ofron për një zgjidhje më të shpejtë të problemeve të krijuara, më efektive dhe më pak të kushtueshme.</p>
<p>Neni 34</p> <p>Fillimi i procedurës së arbitrazhit</p>	<p><u>Komenti ICC-së:</u></p>	<p>Refuzohet komenti ICC.</p>	<p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e ICC:</u></p>

<p>1. Nëse në marrëveshjen e lidhur midis palëve nuk parashikohet ndryshe, procedura e arbitrazhit për një mosmarrëveshje fillon:</p> <p>a) në datën kur institucioni i përhershëm i arbitrazhit merr kërkesën për fillimin e procedurës së arbitrazhit, nëse procedurat e arbitrazhit zhvillohen <i>dhe administrohen nga një institucion përhershëm arbitrazhi</i>;</p> <p>b) në datën në të cilën kërkesa për arbitrazh i njoftohet palës së paditur, në çdo rast tjetër (arbitrazhi ad hoc).</p>	<p>Kërkesa është dokumenti fillestar që duhet të ndahet nga padia. (shih nenin 40, par.1).</p> <p><u>Komente ASH:</u></p> <p><i>“administrohen nga një institucion përhershëm arbitrazhi”</i>. Hera e parë që del ky term në ligj?</p>	<p>Pranohet komenti ASH.</p>	<p>Sipas edhe modeleve të legjislacioneve të huaja, procedura e arbitrazhit konsiderohet e filluar kur merret kërkesa dhe jo kërkesë padia. Me dorëzimin e kërkesës së arbitrazhit inicion dhe procedura e arbitrazhit.</p> <p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e ASH:</u></p> <p>Do të mbahet në konsideratë gjatë ripunimit të aktit.</p>
<p>Neni 35</p> <p>Kërkesa për arbitrazh</p> <p>1. Kërkesa për arbitrazh duhet të përmbajë:</p> <p>a) gjeneralitetet që bëjnë të mundur identifikimin e palëve, të dhënat</p>	<p><u>Komenti ICC-së:</u></p> <p>Këto pika është mirë të referohen si kërkesa që duhet të përmbushë padia dhe jo kërkesa për Arbitrazh, në mënyrë që të respektohet edhe terminologjia dhe institucionet e procedurës së arbitrazhit të parashikuara nga modelet e rregullave</p>	<p>Pranohet koment ICC-së.</p>	<p>Gjatë ripunimit në terësi të projektaktit do të rregullohet në mënyrë të detajuar dhe reflektohen komentet e ICC-së dhe Euralius nëlidhje me saktësimin eterminit kërkesë dhe kërkesë padi.</p>

<p>elektronike dhe postare të kontaktit të palës paditëse dhe të paditur dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë;</p> <p>b) objektin e kërkesës;</p> <p>c) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese, të së drejtës mbi të cilat mbështetet kërkesa, si dhe kërkimin konkret të palës paditëse; Marrëveshja bazë për të cilën ka lindur konflikti objekt i kërkesës për arbitrazh dhe marrëveshja e arbitrazhit duhet të paraqiten në origjinal ose kopje të vërtetuara me origjinalin.</p>	<p>institucionale më të mira, siç është neni 41 dhe neni 52 i rregullave të ICC-së.</p> <p><u>Koment Euralius:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. The term “request for arbitration” seems odd. Both in the UNCITRAL model laë and the laës of all other countries is “statement of claim” (see Article 23 of the Model Laë). “Request for arbitration” seems inapplicable (differently from ‘request for mediation’ for instance) since the right to enter into arbitration is decided by virtue of the arbitration agreement and the parties are bounded by it, ëhile the term “request” presupposes a level of discretion. 2. discrepancy in terms betëeen the “request” and “counter-claim”. 	<p>Pranohet komenti Euralius-së.</p>	
--	--	---	--

<p>ç) listën e personave që kërkon të thirren në cilësinë e dëshmitarit, duke saktësuar emrin, atësinë, mbiemrin dhe adresën e plotë, si dhe faktet që kërkohet të provohen me to;</p> <p>d) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit;</p> <p>dh) çdo dokument tjetër që pala paditëse e çmon të vlefshëm për të mbështetur parashtrimet e saj.</p> <p>2. Kërkesa për arbitrazh duhet të shoqërohet nga:</p> <p>a) marrëveshja e arbitrazhit;</p> <p>b) marrëveshjen bazë për të cilën ka lindur mosmarrëveshja objekt i kërkesës për arbitrazh</p>			
--	--	--	--

<p>c) dokumentat të cilave u referohet paditësi në kërkesën për arbitrazh.</p> <p>3. Dispozitat e këtij neni zbatohen <i>mutatis mutandis</i> edhe për kundërpadinë.</p>			
<p>Neni 37 Deklarata e mbrojtjes</p> <p>1. Pala e paditur duhet t'i njoftojë palës kërkuese dhe të depozitojë pranë institucionit të arbitrazhit deklaratën e mbrojtjes dhe dokumentacionin mbështetës, brenda afatit të përcaktuar nga palët ose nga institucioni i arbitrazhit. Afati duhet të jetë në cdo rast jo më pak se 15 ditë nga dita e marrjes së kërkesës për arbitrazh nga i padituri.</p>	<p><u>Komenti ICC-së:</u> Përgjigje e kërkesës për arbitrazh duhet të dallohet nga Deklarata e Mbrojtjes pas krijimit të tribunalit dhe pasi kanë filluar procedurat e arbitrazhit të miratuar nga Palët në vijim të komunikimit nga tribunalit. Sugjerojmë se kjo pjesë nuk është e qartë në tekst. Modeli ICC dhe UNCITRAL mund të merret si model.</p> <p><u>Komenti ASH:</u> Afati duhet të jetë në cdo rast jo më pak se 15 ditë. Pse jo 30 dite si ne rregullat e ICC?</p>	<p>Pranohet komenti ICC.</p> <p>Refuzohet komenti ASH.</p>	<p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e ICC:</u> Në lidhje me sugjerimin do të bëhen riformulimet e paragrafit të parë për të saktësuar dispozitën përkatëse.</p> <p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e ASH:</u> ICC nuk ka sugjeruar rishikim të afatit. Për më tepër, sikurse u nënvizua më sipër, interesi i palëve për t'ja nënshtruar gjkimin e mosmarrëveshjeve arbitrazhit, bëhet pasi ato besojnë se procedura</p>

<p>2. Deklarata e mbrojtjes duhet të përmbajë:</p> <p>a) gjeneralitetet që bëjnë të mundur identifikimin e palëve, të dhënat elektronike dhe postare të kontaktit të palës paditëse dhe të paditur dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë;</p> <p>b) tregimin konkret të fakteve, rrethanave, dokumenteve dhe provave të tjera, si dhe prapësimet dhe argumentet për kundërshtimin e kërkesës, nëse ka;</p> <p>c) listën e personave që kërkon të thirren në gjykim me cilësinë e dëshmitarit si dhe faktet që kërkohet të provohen me to;</p>			<p>e arbitrazhit ofron për një zgjidhje më të shpejtë të problemeve të krijuara, më efektive dhe më pak të kushtueshme.</p>
--	--	--	--

<p>ç) provat që kërkohen të merren tek të tretët ose te pala paditës;</p> <p>d) llojin e ekspertimit që kërkohet të kryhet gjatë gjykimit;</p> <p>dh) kundërpadia, nëse ka dhe është objekt i zgjidhjes me arbitrazh.</p> <p>e) çdo akt tjetër që pala e paditur e çmon të vlefshëm për të mbështetur prapësimet e saj.</p> <p>3. Mosdorëzimi i deklaratës së mbrojtjes nuk përbën pengesë për vijimin e gjykimit të mosmarrëveshjes.</p>			
<p>Neni 38</p> <p>Ndryshimi dhe plotësimi i pretendimeve</p> <p>1. Përveç nëse janë dakordësuar ndryshe, gjatë procesit të gjykimit të</p>	<p><u>Komenti ICC-së:</u></p> <p>Sugjerojmë të përcaktohet periudha brenda së cilës lejohet ndryshimi.</p> <p><u>Komenti ASH:</u></p>	<p>Refuzohet komenti i ICC dhe ASH.</p>	<p><u>Vlerësim në lidhje me komentin e ICC-së dhe ASH-së:</u></p> <p>Nuk mund të përcaktohet afat, pasi vlerësojme se duhet të jetë në</p>

<p>arbitrazhit, palët mund të ndryshojnë apo plotësojnë kërkesë padinë për arbitrazh ose deklaratën e mbrojtjes, me kusht që edhe pas ndryshimit dhe plotësimit kërkimi në kërkesë padinë e palëve të ketë lidhje me marrëveshjen e arbitrazhit. Gjykata e arbitrazhit nuk do të lejojë ndryshimin dhe plotësimin nëse konsideron se ky ndryshim/ plotësim është/janë paraqitur me vonesë.</p>	<p><i>“Nuk do të lejojë ndryshimin dhe plotësimin nëse konsideron se ky ndryshim/ plotësim është/janë paraqitur me vonesë”. Sa kohë dispozita nuk parashikon një afat deri kur mund të bëhen ndryshime në kërkesë padi dhe deklaratën e mbrojtjes, si përcaktohet fjala “me vonesë”?</i></p>		<p>diskrecionin e gjykatës të përcaktojë afatet gjatë zhvillimit të procedurës.</p>
<p>Neni 39 Seancat dëgjimore dhe procedurat me shkrim</p> <p>1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit mund vendosë nëse do të mbahet seanca dëgjimore apo nëse procedura do të zhvillohet vetëm në bazë të</p>	<p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p><i>Në pikën 2 të përcaktohet afat, pasi term “afat i arsyeshëm”, është deklarativ/përgjithshëm. (Isn’t it better to be specific about the time? Reasonable time is a very broad and blurred notion)</i></p>	<p>Refuzohet.</p>	<p>Për analogji, komenti më sipër:</p> <p>Nuk mund të përcaktohet afat, pasi vlerësojme se duhet të jetë në diskrecionin e gjykatës së arbitrazhit të përcaktojë afatet gjatë zhvillimit të procedurës. Gjykata njofton palët në rast se vendos të zhvillojë një seancë dëgjimore.</p>

<p>dokumenteve dhe materialeve të tjera të shkruara. Gjykata e arbitrazhit vendos të zhvillojë një seancë dëgjimore kur vlerësohet e arsyeshme, duke pasur në konsideratë rrethanat e çështjes, ose mbi bazën e kërkesës së njëjës prej palëve. Seancat dëgjimore nuk janë publike, përveç nëse palët kanë rënë dakord ndryshe.</p> <p>2. Palët duhet të informohen paraprakisht dhe në një kohë të arsyeshme në lidhje me çdo seancë dëgjimore dhe çdo mbledhje të gjykatës së arbitrazhit e cila ka për qëllim marrjen e provave.</p> <p>3. Të gjitha deklaratat, kërkesat, aktet ose informacionet e tjera të cilat njëra palë i dorëzon gjykatës së arbitrazhit i njoftohen palës tjetër. Gjithashtu, palëve i</p>			
--	--	--	--

<p>komunikohet çdo raport eksperti ose dokument provues në të cilin gjykata e arbitrazhit mund të mbështetet në marrjen e vendimit të saj.</p>			
<p style="text-align: center;">Neni 40 Pasojat e mosveprimit të palëve</p> <p>1. Në rast se paditësi nuk e paraqet kërkesën për arbitrazh në përputhje me nenin 35, gjykata e arbitrazhit përfundon procedurën e arbitrazhit dhe pushon gjykimin.</p> <p>2. Në rast se i padituri nuk paraqet deklaratën e mbrojtjes në përputhje me nenin 37, gjykata e arbitrazhit vazhdon procedurat, duke mos e vlerësuar mosparaqitjen e këtij dokumenti nga ana e të</p>	<p><u>Koment ICC-së:</u></p> <p>1. Sugjerojmë që të parashikohet mosparaqitja për shkaqe të arsyeshme dhe mundësia për videokonferencë pasi të shqyrtohen shkaqet nga tribunali dhe të merret një vendim.</p> <p><u>Komenti i KLGJ-së:</u></p> <p>Në pikën 1 të këtij neni, të shtohet fjalia “kjo nuk pengon riparaqitjen e një kërkesë të re”.</p> <p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>1. Në lidhje me parashikimin “gjykata e arbitrazhit përfundon procedurën e arbitrazhit dhe pushon gjykimin”</p>	<p>Pranohet komenti ICC-së.</p> <p>Refuzohet pjesërisht Komenti i KLGJ-së.</p>	<p>Në lidhje me komentin e ICC, do të vijohet me rregullimin në përmbajtje të projektaktit.</p> <p>Në lidhje me komentin e KLGJ-së, nuk reflektohet për sa kohë procedura e arbitrazhit është thelbësisht e ndryshme nga procedura gjyqësore klasike. Gjithsesi, ky parashikim mund të rivlerësohet me qëllim saktësimin nëse pala mund të fillojë një procedurë të re arbitrazhi.</p>

<p>paditurit si pranim nga ana e tij të pretendimeve të paditësit.</p> <p>3. Nëse një palë nuk paraqitet në seancë ose nuk paraqet prova shkresore brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykata e arbitrazhit mund të vazhdojë procesin e gjykimit dhe të marrë vendimin mbi provat e paraqitura deri në atë moment prej saj.</p> <p>4. Gjkata e arbitrazhit nuk merr parasysh mosveprimet sipas paragrafëve më sipër nëse pala ka shkak të arsyeshëm. Palët mund të bien dakord ndryshe për pasojat që sjell mospërbushja e detyrimeve sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni.</p>	<p><i>Cfarë lloj vendimi është.? Është i rregulluar në KprC. (Ëhat kind of decision is that? Is it foreseen in CivPrCode?).</i></p>		
---	---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 41 Provat</p> <p>1. Secila palë ka barrën e provës për faktet mbi të cilat mbështeten pretendimet e tyre, përveç kur ka marrëveshje të kundërt midis palëve.</p> <p>2. Gjykata e arbitrazhit përcakton mënyrën e marrjes, pranimit të provave si dhe vlerësimin e tyre.</p> <p>3. Në çdo kohë gjatë procedurës, gjykata e arbitrazhit mund të kërkojë nga palët që të paraqesin dokumente ose prova të tjera brenda afatit të caktuar prej saj.</p>	<p>Komenti ICC-së:</p> <p>Në cilin ligj apo praktikë janë bazuar parashikimet sipas këtij paragrafi? As UNCITRAL dhe as legjislacioni shqiptar nuk e parashikojnë një kusht kontraktual të tillë <i>“Secila palë ka barrën e provës për faktet mbi të cilat mbështeten pretendimet e tyre, përveç kur ka marrëveshje të kundërt midis palëve”</i>.</p> <p>Komenti Euralius:</p> <p>Ka competence gjykata e arbitrazhit të kërkojë marrjen e provave apo është kompetencë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm? Apo vetëm palët kanë barrën e provës? <i>(Ëhat about other state or private bodies? Can the arbitration court ask for the documents or must it address the “court” (state court) to ask for it? Or is it solely the parties’ burden? Probably Art. 44 covers that but maybe there should be referral to this provision here?)</i></p>	<p>Refuzohet komenti ICC-së.</p> <p>Refuzohet Komenti Euralius.</p>	<p>Mendojmë se sugjerimi i përcjellë nuk konsiston në një propozim konkret. Gjithsesi ky parashikim ka pasur për qëllim rastet kur njëra nga palët nuk disponon provat e nevojshme (ose nuk ka akses), ndaj me marrëveshje midis tyre mund të dakordësojnë paraqitjen e provave nga pala tjetër. Për më tepër në lidhje me komentin që UNCITRAL nuk parashikojnë një kusht të tillë, sillet në vemëndje UNCITRAL Notes on Organizing Arbitral Proceedings⁹, cili parashikon <u>“the parties may consider submitting jointly a single set of documentary evidence. The purpose èould be to avoid duplicate submissions and unnecessary discussions concerning the authenticity of documents, èithout prejudicing the position of the parties concerning the content of the documents. Additional documents may be inserted later if the parties agree.”</u></p> <p>Vlerësim në lidhje me komentin Euralius:</p>
--	---	---	--

⁹ UNCITRAL Notes on Organizing Arbitral Proceedings.

			Për analogji, neni 44 “Mbështetja e gjykatës në marrjen e provave”
<p style="text-align: center;">Neni 42 Dëshmitarët</p> <p>1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, dëshmitarët thirren për të dëshmuar gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore. Kur një dëshmitar refuzon të paraqitet vullnetarisht, gjykata e arbitrazhit, kur e vlerëson të përshtatshme sipas rrethanave, mund t'i kërkojë kryetarit të gjykatës së rrethit gjyqësor të vendit të arbitrazhit, që të urdhërojë marrjen e provës.</p> <p>2. Dëshmitarët, me pëlqimin e palëve, mund të pyeten nga gjykata e arbitrazhit jashtë seancave dëgjimore ose mund të kërkohen që t'i përgjigjen me</p>	<p>Komenti ICC-së:</p> <p>Sugjerojmë heqjen e fjalisë së fundit të këtij paragrafi, pasi është parim i procesit penal dhe jo i një “procesi civil” me objekt pasuror.</p> <p>Nga interpretimi i dispozitës nënkuptohet se urdhërimi i marrjes së provës do të thotë të detyrosh dëshmitarin të dëshmojë.</p> <p>Në arbitrazh dëshmitarët dhe ekspertët nuk mund të dëgjohen jashtë seancës, pasi vetë seanca bëhet për të shqyrtuar dëshmitarët dhe ekspertët.</p> <p>Ekzaminimi në seancë duhet të bëhet vetëm pasi dëshmitarët ose ekspertiza të kenë dorëzuar paraprakisht pranë gjykatës materialet e dëshmisë ose ekspertizës.</p> <p>Dëshmitarët dëgjohen dhe pyeten nga gjykata e arbitrazhit, duke zbatuar, për aq sa është e zbatueshme, parashikimet e legjislacionit procedural civil për pyetjen e</p>	Refuzohet pjesërisht.	<p>Rregullimet në lidhje me këtë nen janë adaptuar nga legjislacioni Kroat dhe Belg për arbitrazhin. Ndërkohë, neni i cili rregullon caktimin dhe dëgjimin e ekspertit, adopton <u>nenin 26 të ligjit model UNCITRAL si dhe parashikimet e dispozitave mbi arbitrazhin të Austrisë, Gjermanisë, Italisë, Kroacisë, Polonisë dhe Sllovenisë.</u></p> <p>Për me tëpër ky parashikim respekton parimet e procesit civil, pasi ja delegon gjykatës së rrethit, kur e vlerëson të përshtatshme sipas rrethanave, të drejtën për marrjen e provës.</p>

<p>shkrim pyetjeve të gjykatës së arbitrazhit brenda një periudhe të caktuar kohore të caktuar.</p> <p>3. Dëshmitarët dëgjoen dhe pyeten nga gjykata e arbitrazhit, duke zbatuar, për aq sa është e zbatueshme, parashikimet e legjislacionit procedural civil për pyetjen e dëshmitarëve.</p>	<p>dëshmitarëv. Ky togfjalësh shfuqizon fjalinë e dytë në paragrafin 1. sipas komentit të dhënë përkatësisht.</p>		
<p>Neni 45 Kompensimi</p> <p>1. Arbitrat mund të marrin në shqyrtim kërkesat për kompensim, në kufijtë e vlerës së çështjes, edhe nëse kredia për kompensim nuk përfshihet në fushën e zbatimit të marrëveshjes së arbitrazhit.</p>	<p><u>Komenti ICC-së:</u> Për çfarë lloj kompensimi nënkuptohet? Kjo dispozitë ka nevojë për saktësim.</p> <p><u>Komenti ASH:</u> Pretendim per kompensim?</p>	<p>Pranohet komenti ICC dhe ASH.</p>	<p>Duhet rivlerësuar më qëllim saktësimin e parashikimit, pasi është i paqartë.</p>
<p>Neni 46</p>	<p><u>Komenti ICC-së:</u></p>	<p>Pranohet pjesërisht.</p>	<p><u>Në lidhje me komentin e ICC:</u></p>

<p>Marrja e masave për sigurimin e padisë</p> <p>1. Gjykata e arbitrazhit, me kërkesën e njëres prej palëve, mund të vendosë marrjen e masave për sigurimin e padisë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt ndërmjet palëve ose kur kjo nuk lejohet nga ligji i zbatueshëm i zgjedhur nga palët në marrëveshjen e arbitrazhit. Nëse palët nuk kanë vendosur rregulla për një qëllim të tillë, gjykata e arbitrazhit zbaton rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile për sigurimin e padisë.</p> <p>2. Kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë mund të paraqitet në çdo kohë përpara dhënies së vendimit përfundimtar të arbitrazhit, me akt që i njoftohet palëve dhe</p>	<p><i>“Vendimi i gjykatës së arbitrazhit që cakton një masë sigurimi përbën titull ekzekutiv.”</i></p> <p>Ky parashikim është në konflikt me Nenin 14, par. 2 të këtij ligji. Me këtë parashikim duhet marrë në konsideratë edhe jurisprudenca shqiptare, e cila në momentin që është paraqitur një vendim për sigurim padie e marrë në SHBA, gjykata shqiptare nuk e ka njohur pasi e ka gjetur në kundërshtim me nenin 5/1/e të Konventës së NY pasi nuk ka është vendim i formës së prerë (vendim nr. 34, dt. 01.03.2012 Gjykata e Apelit Tiranë).</p> <p><u>Komenti ASH-së:</u></p> <p><i>“ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit do të bëhej i pamundur apo do të vështirësohej së tepërmi me kushtin që të ekzistojë mundësia e arsyeshme e një vendimi në favor të palës kërkuese”</i> Vendimi për themelin apo vendimi për masën e sigurisë? Nuk e kuptoj. Si mund të bësh vlerësimin për një vendim të mundshëm në favor të palës kërkuese sa kohë që akoma ska një vendim?</p>		<p>Neni 14, para 2 duhet rivlerësuar në reflektim të sugjerimit të dhënë.</p> <p>Në lidhje me komentin në para 2 nuk reflektohet pasi sipas projektligjit, <u>ky ligj rregullon arbitrazhin vendas dhe arbitrazhin ndërkombëtar kur vendi i arbitrazhit është në Republikën e Shqipërisë.</u></p> <p><u>Në lidhje me komentin e ASH-së:</u></p> <p>Ky parashikim gjendet edhe ne modelet e legjislacioneve të huaja. Si shëmbull sillet ligji gjerman.</p>
---	---	--	--

<p>arbitrave kur ekzistojnë kushtet e mëposhtme:</p> <p>a) pala kërkuese mund të pësojë një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm gjatë kohës së nevojshme deri në lëshimin e vendimit të arbitrazhit;</p> <p>b) ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit do të bëhet i pamundur apo do të vështirësohet së tepërmi me kushtin që të ekzistojë mundësia e arsyeshme e një vendimi në favor të palës kërkuese.</p> <p>3. Kur e vlerëson të përshtatshme, gjykata e arbitrazhit mund të kushtëzojë marrjen e masës së sigurimit me dhënien e një garancie në të holla ose dorëzanie, duke përcaktuar objektin, mënyrën e vënies në garaci dhe afatin.</p> <p>4. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit që cakton një masë</p>			
--	--	--	--

<p>sigurimi përbën titull ekzekutiv.</p> <p>5. Në prani të shkaqeve të justifikuara të ndodhura pas vendimit që pranon masën e sigurimit, dhe pasi ka dëgjuar palët, gjykata e arbitrazhit mund të vendosë heqjen e saj.</p>			
<p>Neni 47</p> <p>Ankimi ndaj vendimit për masën e sigurimit</p> <p>1. Kundër vendimit të gjykatës së arbitrazhit që ka vendosur pranimin, refuzimin ose heqjen e masës së sigurimit lejohet ankimi në gjykatën e apelit të vendit të arbitrazhit, brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.</p> <p>2. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të ankimuar.</p>	<p><u>Komenti ICC-së:</u></p> <p>Ankimi ndaj masës së sigurimit duhet të lejohet vetëm në vendimin përfundimtar, pasi duhet ruajtur autonomia e procedurës së arbitrazhit nga shqyrtimi i gjykatave.</p>	<p>Refuzohet</p>	<p>Ajo që vlen të theksohet në lidhje me këtë parashikim është se ankimi ndaj masës së sigurimit merr në konsideratë vetë karakteristika të masës së sigurimit të padisë që është urgjencia dhe domosdoshmëria për të ngrirë gjendjen deri sa të vërtetohet e drejta nëpërmjet vendimit të themelit. E drejta e ankimit të veçantë të vendimit të gjykatës së arbitrazhit përpara Gjykatës së Apelit, ka qëllim garantimin e vetë thelbit të masës së sigurimit të padisë dhe në mënyrë që kjo urgjencë dhe domosdoshmëria të gjëjë mbrojtje të barabartë ligjore. Gjithashtu krijon një barazi të mjeteve ligjore në dispozicion të palëve duke krijuar kështu një të drejtë për t'u mbrojtur nga një shkelje e rëndë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 48</p> <p>Rregullat e zbatueshme për themelin e mosmarrëveshjes</p> <p>1. Gjykata e arbitrazhit vendos mbi mosmarrëveshjen në përputhje me parashikimet e ligjit të zgjedhur nga palët si të zbatueshëm për themelin e mosmarrëveshjes. Çdo përcaktim i ligjit ose sistemit ligjor të një shteti të caktuar, përveç kur është rënë shprehimisht dakord ndryshe nga palët, interpretohet se i referohet drejtpërdrejt ligjit material të atij shteti dhe jo rregullimit të tij ligjor për të drejtën ndërkombëtare private.</p> <p>2. Gjykata e arbitrazhit, në mungesë të përcaktimit nga palët sipas pikës 1 të këtij neni, zbaton rregullat që vlerëson të përshtatshme për palët.</p>	<p>Komenti ICC-së:</p> <p>Propozojmë që pjesë të paragrafit të hiqen si më sipër propozuar. Detajime të tilla krijojnë ngatërresë pasi është e pamundur që ligji të parashikojë të gjitha situatat ligjore që mund t'i paraqiten gjykatës së arbitrazhit për zgjidhje.</p>	<p>Pranohet</p>	<p>Do të reflektohet gjatë ripunimit në terësi të projektaktit.</p>
---	---	-----------------	---

<p>3. Gjykata e arbitrazhit mund të vendosë zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas parimit <i>ex aequo et bono</i> ose <i>amiable compositeur</i> vetëm nëse palët kanë rënë dakord shprehimisht.</p> <p>4. Gjykata e arbitrazhit, në të gjitha rastet, vendos në përputhje me kushtet e kontratës dhe merr në konsideratë zakonet tregtare të zbatueshme për transaksionin.</p>			
<p style="text-align: center;">Neni 52 Efektet e vendimit</p> <p>1. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit është i formës së prerë në lidhje me marrëveshjen e shqyrtuar, që nga momenti që shpallet.</p>	<p>Komenti ICC-së:</p> <p>Përsa kohë lejohet ankimi, vendimi nuk mund të jetë i formës së prerë por mund të quhet përfundimtar. Një vendim i tillë është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm vetëm pas përfundimit të shqyrtimit në Apel dhe vendimit të Apelit nëse palët kanë rënë dakord.</p>	<p>Pranohet</p>	<p>Do të reflektohet gjatë ripunimit në terësi të projektaktit. Duhet të rishikohet në përputhje me nenin 59 të projektaktit.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 53 Ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit</p> <p>1. Pala që dëshiron të vërë ne ekzekutim vendimin e arbitrazhit në territorin e Shqipërisë, paraqet kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit në gjykatën e rrethit gjyqësor të vendit të arbitrazhit, duke depozituar vendimin dhe marrëveshjen e arbitrazhit, në origjinal ose kopje të njehsuar me origjinalin.</p> <p>2. Gjykata pasi verifikon përmbajtjen e vendimit, sipas nenit 50 të këtij ligji, lëshon urdhrin e ekzekutimit dhe njofton palët. Kundër vendimit të gjykatës që lëshon urdhrin e ekzekutimit nuk lejohet ankim.</p>	<p><u>Komenti ICC-së:</u></p> <p>Depozitimi i marrëveshjes nuk është kusht i nevojshëm.</p> <p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>“Pala që dëshiron të vërë ne ekzekutim vendimin e arbitrazhit në territorin e Shqipërisë, paraqet kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit në gjykatën e rrethit gjyqësor të vendit të arbitrazhit” ky parashikim është I paqartë dhe mbivendoset, rregullat e ekzekutimit të vendimeve të gjykatës së arbitrazhit janë të ndryshme në varësi nëse nëse është arbitrazh vendas apo ndërkombëtar. Në rast të vendimeve të gjykatës së arbitrazhit ndërkombëtar, vendimi do të ekzekutohet vetëm pas njohjes nga Gjykata e Apelit sipas KprC. <i>(There is a discrepancy here, because the rules of execution of arbitration decisions are different depending ehen it is a case of decisions of domestic or international arbitration tribunals: In the case of international arbitration tribunals, the decision can be executed only after being</i></p>	<p>Refuzohet komenti ICC-së.</p> <p>Pranohet pjesërisht komenti Euralius.</p>	<p><u>Vlerësim i komentit të ICC-së:</u></p> <p>Marrëveshja përbën thelbin e fillimit të procedurës së arbitrazhit ndaj vlerësohet substanciale depozitimi i saj në gjykatë.</p> <p><u>Vlerësim i komentit të Euralius:</u></p> <p>Pika 1 duhet riformuluar me qëllim saktësimin nëse rregullon rastet kur vendimi i arbitrazhit është dhënë në territorin e shqipërisë, duke marrë parasysh edhe parashikimet e Konventës së Neë york:</p> <p>Neni 1 This Convention shall <u>apply to the recognition. and. Enforcement of arbitral aëards made in the territory of a State other. than the State ëhere the. recognition. and. enforcement of, such aëards are sought and arising out of differences betëeen persons.</u></p>
---	---	---	--

<p>3. Vendimit i gjykatës që refuzon lëshimin e urdhrit të ekzekutimit duhet të jetë i arsyetuar. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve duke filluar nga dita e nesërme e marrjes dijeni mbi vendimin.</p>	<p><i>recognised by the Court of Appeal as per Article 339 and Article 510(2)(c) of the Civil Procedure Code.)</i></p>		
<p style="text-align: center;">Neni 54 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim</p> <p>1. Kur gjatë procedurës së arbitrazhit, palët zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim, gjykata e arbitrazhit përfundon procedurën e arbitrazhit dhe, nëse kërkohet nga palët dhe nuk kundërshtohet nga gjykata e arbitrazhit, dokumenton marrëveshjen në formën e një vendimi arbitrazhi, në bazë të</p>	<p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>Ky parashikim përfshin dhe zgjidhjen e marrëveshjes nëpërmjet ndërmjetesimit? Duhet të qartësohet më qëllim që të mos krijohet konfuzion. <u>(Does this include also settlement through mediation?! Need to make clear in order to avoid possible misunderstanding betëeen the terms, ëhich often occur in practice (as mentioned in earlier comments).</u></p> <p><u>Komenti ASH:</u></p> <p>Do ripare?</p>	<p>Komenti Euralius refuzohet.</p> <p>Komenti ASH refuzohet pasi është i pqartë sugjerimi.</p>	<p>Përfshin vetem rregullimin me mirëkuptim të palëve. Ndërmjetsimi rregullohet nga një ligj i posacëm.</p>

<p>kushteve të rëna dakord nga palët.</p> <p>2. Marrëveshja e palëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me mirëkuptim, me kërkesë të palëve, bëhet pjesë e vendimit të arbitrazhit, me përjashtim të rastit kur përmbajtja e marrëveshjes është në kundërshtim me ligjin dhe me rendin publik. Vendimi i arbitrazhit merret në përputhje me dispozitat e nenit 50 dhe shpallet si vendim i gjykatës së arbitrazhit. Ky vendim ka efekt të njëjtë me çdo vendim tjetër të marrë mbi themelin e çështjes.</p>			
<p>Neni 57</p> <p>Vendimi mbi shpenzimet e procedurës së arbitrazhit</p> <p>1. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, gjykata e</p>	<p>Komenti i MFE:</p> <p>Të shtohet një parashikim në fund, me anë të të cilit të qartësohet se masa e tarifave dhe cdo shpenzim tjetër i procesit përcaktohen në marrëveshjes e arbitrazhitm me perjashtim të atyre</p>	<p>Refuzohet komenti.</p>	<p>Parashikimet në këtë nen përcaktojnë qartë që shpenzimet do përcaktohen sipas këtij neni “Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe”. Palët janë të lira të vendosin në marrëveshje për shpenzimet.</p>

<p>arbitrazhit cakton shpenzimet në vendimin përfundimtar. Në shpenzime përfshihen:</p> <p>a) tarifa e gjykatës së arbitrazhit;</p> <p>b) shpenzimet dhe shpërblimet e arbitrit/arbitrave;</p> <p>c) shpenzimet për ekspertët dhe ndihmën tjetër të cilën e ka kërkuar gjykata e arbitrazhit dhe për të cilën janë pajtuar palët;</p> <p>ç) shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera të dëshmitarëve, deri në masën e miratuar nga gjykata e arbitrazhit;</p> <p>d) shpenzimet për përfaqësimin dhe këshillimin ligjor për palën e suksesshme, nëse kompensimi i këtyre shpenzimeve është kërkuar gjatë procedurës së arbitrazhit, dhe vetëm deri</p>	<p>shpenzimeve që janë tashmë të rregulluara nga legjislacioni I fushës. Ky koment lidhet me faktin se këto shpenzime përballohen nga pala humbëse dhe sit ë tilla duhet të jenë objekt i vendimarrjes së palëve.</p>		
--	---	--	--

<p>në atë masë që gjykata e arbitrazhit e vlerëson të arsyeshme; dhe</p> <p>dh) të gjitha taksat dhe shpenzimet e gjykatës së arbitrazhit, kur kjo bën emërimin e arbitrave.</p> <p>2. Shpenzimet e gjykatës së arbitrazhit duhet të jenë të arsyeshme, duke marrë parasysh vlerën e çështjes, kompleksitetin e lëndës, kohën e shpenzuar nga arbitrat dhe rrethanat e tjera të rastit. Në rast se shfaqen mosmarrëveshje në lidhje shpenzimet e caktuara nga gjykata e arbitrazhit, është gjykata e arbitrazhit që do të vendosë mbi këtë çështje.</p> <p>3. Nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, shpenzimet e arbitrazhit i ngarkohen palës humbëse. Gjykata e arbitrazhit</p>			
--	--	--	--

<p>mund të ndajë shpenzimet e parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni ndërmjet palëve, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes dhe rezultatin e procedurës së arbitrazhit, si dhe sjelljen penguese të ndonjëres nga palët gjatë procesit të arbitrazhit.</p>			
<p style="text-align: center;">Neni 58 Ankimi</p> <p>1. Ankimi ndaj një vendimi arbitrazhi mund të bëhet vetëm përmes kërkesës për konstatimin e pavlefshmërisë dhe shfuqizimin e vendimit, kur ekziston një nga shkaqet e parashikuara nga neni 59 i këtij ligji.</p> <p>2. Vendimet e gjykatës së arbitrazhit mbi çështje të ngritura nga palët gjatë procedurës së arbitrazhit mund</p>	<p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>2. Termi ankim nuk përdoret në Ligjin model të UNCITRAL dhe në legjislacionet e BE dhe vendeve të rajonit, duke qënë se vendimi i arbitrazhit nuk ankimohet në thelb por mund “të shmanget/menjanohet” vetëm për raste të veçanta të listuara në Nenin 59. <i>(The term “appeal” is not used in the UNCITRAL Model Law and in any of the other EU and regional countries, since arbitration decisions cannot be challenged indiscriminately but can be “set aside” under very specific and limited</i></p>	<p>Komente Euralius:</p> <p>1. Refuzohet; 2. Pranohet</p>	<p>1. Terminologjia e përdorur vlerësohet se nuk prek përmbajtjen e parashikimit. Në thelb vendimi i gjykatës së arbitrazhit sjell efekte dhe pasoja njësoj si vendimi i gjykatës. Për më tepër shqyrtimi i konstatimit të pavlefshmërisë së marrëveshjes, i nënshtrohet juridiskionit të gjykatave të zakonshëm, normat procedurale të cilave përdorin term “ankim” dhe jo “set aside/shamngje/menanjim).</p> <p>2. Në lidhje me komentin e dytë, do të reflektohet në përmbajtje.</p>

<p>të ankimohen bashkarisht me vendimin përfundimtar mbi themelin e çështjes.</p> <p>3. Ankimi paraqitet në Gjykatën e Apelit Tiranë të vendit të arbitrazhit</p>	<p><i>grounds which have been listed in Article 59 below).</i></p> <p>3. Të përcaktohet Gjykata e Apelit Tiranë si gjykata kompetente (<i>Should suggest to reconsider and give the powers only to the Tirana Court of Appeal, in order to ensure adequate specialisation of judges and quality of "setting aside" decisions).</i></p>		
<p>Neni 59</p> <p>Rastet kur lejohet ankimi / Shkaqet e pavlefshmërisë</p> <p>1. Vendimi i arbitrazhit mund të ankimohet vetëm për shkaqet e mëposhtme të pavlefshmërisë:</p> <p>a) marrëveshja e arbitrazhit është e pavlefshme, sipas ligjit të përzgjedhur nga palët, ose, në mungesë të përzgjedhjes nga palët, të ligjit material të zbatueshëm për themelin e mosmarrëveshjes sipas</p>	<p><u>Komenti ICC-së:</u></p> <p>Sugjerojmë që të mundësohet përkufizimi i termit "rend publik" në mënyrë që të krijohet siguri juridike për interpretimin e tij.</p> <p><u>Komenti Euralius:</u></p> <p>Të përcaktohet qartë çfarë do të nënkuptohet me termin rend public? (<i>Shouldn't it be a bit more limited, e.g. "ëith the fundamental principles of public order"?</i>) <i>But again, maybe I exaggerate- it is a matter of practice and interpretation of the notion in line ëith UNCITRAL principles)</i></p>	<p>Refuzohet koemtni ICC-së dhe Euralius.</p>	<p>Duhet të vlerësohet dhe interpretohet rast pas rasti nga gjykata.</p>

<p>nenit 48 të këtij ligji, me kusht që ky pretendim të jetë ngritur gjatë gjykimit të arbitrazhit, në përputhje me parashikimin e nenit 28, pika 3;</p> <p>b) arbitrat nuk janë emëruar në format dhe mënyrat e parashikuara në këtë ligj, me kusht që i njëjti pretendim të jetë ngritur gjatë gjykimit të arbitrazhit;</p> <p>c) vendimi është dhënë nga persona që nuk plotësonin kushtet për të qenë arbitër, sipas nenit 15 të këtij ligji;</p> <p>ç) vendimi është në tejkalim të marrëveshjes së arbitrazhit, me kusht që i njëjti pretendim të jetë ngritur gjatë gjykimit të arbitrazhit, në përputhje me</p>			
---	--	--	--

<p>parashikimin e nenit 28, pika 4;</p> <p>d) vendimi nuk plotëson kushtet e parashikuara nga neni 50, gërmat “d”, “dh” dhe “e” të këtij ligji;</p> <p>dh) vendimi shprehet mbi një mosmarrëveshje që nuk mund të jetë objekt arbitrazhi, sipas parashikimeve të nenit 10 të këtij ligji;</p> <p>e) vendimi nuk shprehet mbi kërkesat dhe pretendimet kryesore të palëve, në përputhje me marrëveshjen e arbitrazhit;</p> <p>ë) gjatë gjykimit të arbitrazhit nuk është respektuar parimi i kontradiktoritetit;</p> <p>f) vendimi është në kundërshtim me rendin publik në Republikën e Shqipërisë.</p>			
---	--	--	--

<p>2. Pala që ka shkaktuar pavlefshmërinë, që ka hequr dorë prej saj, ose që nuk ka ngritur në kërkesën e parë ose në deklaratën e mbrojtjes pretendime lidhur me shkeljen e rregullave që disiplinojnë zhvillimin e procedurës së arbitrazhit, nuk mundet për këtë shkak të ankimojë vendimin.</p> <p>3. Ankimi ndaj vendimit të arbitrazhit për shkelje të dispozitave të ligjit që lidhen me themelin e mosmarrëveshjes lejohet vetëm nëse është parashikuar shprehimisht nga palët në marrëveshjen e arbitrazhit.</p> <p>4. Çdo marrëveshje e palëve për heqjen dorë nga ankimi sipas këtij neni është e pavlefshme.</p>			
Neni 60	Komenti Euralius:	Refuzohen komentet e Euralius.	Pika 1 velrësohet e qartë.

<p style="text-align: center;">Afati i ankimit</p> <p>1. Ankimi në gjykatën e apelit bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arbitrazhit.</p> <p>2. Kërkesa për korrigjimin e vendimit nuk pezullon afatin e ankimit; gjithsesi, vendimi i korrigjuar mund të ankimohet për pjesët e korrigjuara, duke filluar nga data e njoftimit të tij.</p> <p>3. Paraqitja e ankimit ndaj vendimit të arbitrazhit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit. Megjithatë, me kërkesë të palës edhe pas paraqitjes së ankimit, gjykata e apelit mund pezullojë zbatimin e vendimit të arbitrazhit, kur ekzistojnë shkaqet e parashikuara nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Parashikimi se “ankimi në gjykatën e apelit bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arbitrazhit” sugjerohet të riformulohet duke shtuar dhe fjalët “osë njoftimit të vendimit palëve/marrja djeni”. (Or submission to the parties?) 2. Në lidhje me pikën 3 të saktësohet në gjykatë apo në gjykatën e arbitrazhit. (<i>Ëhere? To the arbitration court or to “the court”?</i>) 		<p>Pika 3 është e qartë. Në pikën 1 përcaktohet ankimi në gjykatën e apelit.</p>
---	--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 61 Shqyrtimi nga gjykata e apelit</p> <p>1. Gjkata e apelit shqyrton ankimin sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Civile.</p> <p>2. Gjkata e apelit merr në shqyrtim ankimin brenda 30 ditëve nga depozimi i tij në gjykatë.</p> <p>3. Gjkata e apelit shqyrton ankimin për marrjen e masës së sigurimit të padisë ose provave brenda 20 ditëve nga data e depozitimit.</p> <p>4. Gjkata e apelit shqyrton brenda 90 ditëve nga data e depozitimit çdo ankim tjetër.</p>	<p>Komente ICC-së:</p> <p>Sugjerojmë që ky afat procedural të jetë 30 (tridhjetë) ditë, pasi është joproporcional me një nga qëllimet kryesore të Arbitrazhit (shpejtësia) dhe me vetë faktin që për shqyrtimin e themelit ka një afat 30 (tridhjetë) ditor për kërkesa të tjera afat 90 (nëntëdhjetë) ditor.</p> <p>Sugjerojmë unifikim të terminologjisë (merr në shqyrtim dhe shqyrton).</p>	<p>Pranohen.</p>	<p>Do të reflektohen gjatë ripunimit në terësi të projektaktit.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 62 Vendimi mbi ankimin</p> <p>1. Gjykata e Apelit Tiranë vendos mbi ankimin dhe, kur e pranon, deklaron:</p> <p style="padding-left: 20px;">a. pavlefshmërinë e vendimit të arbitrazhit dhe ia përcjell çështjen gjykatës së arbitrazhit. Nëse pavlefshmëria prek vetëm një pjesë të vendimit, gjykata deklaron pavlefshmërinë e pjeshme të tij.</p> <p>2. Deklarimi i pavlefshmërisë së vendimit të arbitrazhit, bën sërish të zbatueshme marrëveshjen e arbitrazhit për çështjen që është objekt mosmarrëveshjeje, me përjashtim të rastit të</p>	<p><u>Komenti Euralius dhe KLGJsë:</u> Nuk përcaktohet qartë se cilës gjykatë arbitrazhi, asaj të mëparshmes që ka dhënë vendimin apo një gjykatë tjetër arbitrazhi? (Ëith the same arbitrators or different ones? If different, ëhat about the remuneration of the previous ones?)</p> <p><u>Koment Euralius:</u> Në lidhje me parashikimin “Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë”, vlerësojmë se duhet lejuar, sidomos për ceshtjet e juridiksionit. (<i>Ëhy? It should be alloëed, especially ëhen the issue of lack of jurisdiction is raised</i>).</p>	<p>Pranohet komeni euralius dhe KLGJ.</p> <p>Refuzohet komenti Euralius.</p>	<p>Do të saktësohet gjatë ripunimit në terësi të aktit.</p> <p>Në lidhje me këtë koment, theksojmë që në thelb nuk është gjykim/shqyrtim që i nenshtrohet rregullave të zakonshme procedurale civile.</p>

<p>parashikuar nga neni 59, pika 1, gërma “a”.</p> <p>3. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.</p>			
<p>Neni 63</p> <p>Referimi në rregulloret e institucioneve të arbitrazhit</p> <p>1. Marrëveshja e arbitrazhit mund të bëjë referim në rregulloren e një institucioni arbitrazhi. Në rast konflikti ndërmjet percaktimeve të marrëveshjes së arbitrazhit dhe parashikimeve të rregullores, mbizotëron marrëveshja e arbitrazhit.</p> <p>2. Nëse palët nuk kanë parashikuar ndryshe, zbatohet rregullorja në fuqi në momentin e fillimit të procedurës së arbitrazhit.</p>	<p>Komenti ICC-së</p> <p>Institucionet e arbitrazhit duhet të jenë të lira në përcaktimin e rregullave të arbitrazhit pranë institucionit. Për këtë arsye propozojmë që ky paragraf të hiqet.</p>	<p>Refuzohet.</p>	<p>Për analogji vlerësimi i dhënë në lidhje me rregullimin e institucioneve në përmbajtje të projektaktit.</p>

<p>3. Rregullorja e institucioneve të arbitrazhit mund të parashikojë raste shtesë për zëvendësimin dhe përjashtimin e arbitrave, krahas atyre të parashikuara nga ligji.</p> <p>4. Nëse institucioni i arbitrazhit refuzon të administrojë arbitrazhin, marrëveshja arbitrazhit mbetet e vlefshme dhe zbatohen dispozitat e këtij ligji.</p>			
<p style="text-align: center;">Neni 64 Dispozita kalimtare</p> <p>1. Vlefshmëria e marrëveshjeve të arbitrazhit të nënshkruara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji përcaktohet sipas legjislacionit të zbatueshëm në momentin e nënshkrimit të tyre.</p> <p>2. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për procedurat e</p>	<p>Koment Euralius:</p> <p>“Institucionet e arbitrazhit, që kanë ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, brenda 1 viti pas hyrjes së tij në fuqi. Institucionet e arbitrazhit, të cilat nuk përshtaten me <u>dispozitat e këtij ligji, v lerësohen të prishura dhe çregjistrohen nga Regjistri</u>”. Cfarë efekti do të sjellë ky</p>		<p>Vlerësim komenti Euralius: Ky parashikim nuk prek procedurat e mëparshme.</p>

<p>arbitrazhit që kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur palët kanë rënë shprehimisht dakord ndryshe.</p> <p>3. Institucionet e arbitrazhit, që kanë ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, brenda 1 viti pas hyrjes së tij në fuqi. Institucionet e arbitrazhit, të cilat nuk përshtaten me dispozitat e këtij ligji, vlerësohen të prishura dhe çregjistrohen nga Regjistri.</p> <p>4. Procedurat që janë në pritje përpara gjykatave në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë sipas legjislacionit të zbatueshëm përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.</p>	<p>parashikim për procedurat e arbitrazhit të zhvilluara nga këto institucione. <i>(Ëhat ëill be the effect for the arbitration proceedings?)</i></p>		
--	---	--	--

--	--	--	--

- Komentet e parashtruara gjatë tryezës së Konsultimit:
 - znj.Entela Memishaj sa i përket pjesës lidhur me dispozitat e përgjithshme sugjeroi që të kemi një përkuzim të ri në lidhje me arbitrazhin ndërkombëtar.Ky koment do të merret parasysh gjatë ripunimit të aktit.

- Komente të Avokaturës së Shtetit në lidhje me përmbajtjen në terësi të projektligjit:
 - duhen saktësuar afatet e ankimit për subjektet qe janë rezident ne Shqipëri dhe te atyre qe janë jashtë shtetit tone pasi këta te fundit për shkak te vendbanimit (selisë jashtë shtetit shqiptar) ndodhen ne pozita deri diku me pak te favorshme nëse llogarisim momentin e marrjes dijeni te tyre (efektivisht) për vendimin. Disa vende si Franca, parashikojnë një afat 30 ditor për subjektet rezident dhe/ose me seli ne France, ndërsa për subjektet rezident jashtë saj parashikojnë një afat 3 mujor (**Për tu analizuar me kujdes, duke mbajtur ne konsiderate edhe trajtimin e barabrate te paleve**)
 - duhet parashikuar edhe rishikimi i vendimit te arbitrazhit si mjet për kundërshtimin/goditjen e tij se bashku me shkaqet respektive, afatet, kushtet për secilin rast si kur është vendim ne rastin e arbitrazhit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar. Si shkaqe mund te behet referimi tek neni 494 i K.Pr.Civile pasi shkaqet e përcaktuara ne këtë nen mund te gjejnë zbatim edhe për vendimin e arbitrazhit (kjo referuar edhe praktikave te vendeve jashtë) (Sugjerohet të pranohet)
 - për t’u vlerësuar nëse procedura e ankimit te vendimit vlen te konsiderohet efektive dhe ezauruese vetëm me shqyrtimin ne gjykatën e apelit. Ne France për shembull dhe jo vetëm, ka një faze ankimi ne Gjykatën e Apelit Paris, dhe fazën tjetër te kundërshtimit te vendimit te kësaj gjykate ne gjykatën e Larte (**Procedura e ankimit eshte hartuar duke mbajtur ne konsiderate disa modele te legjislacioneve europiane**)
 - për t’u rregulluar edhe efekti juridik qe sjell një vendim i gjykatës se apelit qe vendos anulimin apo rishikimin e vendimit te arbitrazhit. Ne këtë drejtim mbetet për t’u rregulluar pjesa e kundërshtimit te vendimeve te gjykatës për njohjen dhe/ose ekzekutimin e vendimit te arbitrazhit si ne atë vendas dhe atë ndërkombëtar.